

II. Çështja në shqyrtim.

2. Hetimi i thelluar i adresohet shërbimit publik të telefonisë së lëvizshme të ofruar nga dy kompanitë celulare AMC dhe Vodafone.
3. Tregu i telefonisë celulare u hap në Maj të vitit 1996 me licencimin e kompanisë AMC (licensa nr.1) dhe fillimin e aktivitetit të saj.

Në 25.07. 2000, Telenor - Cosmote bleu 85 % të aksioneve të AMC-së, pjesa tjetër prej 12.6% të aksioneve zotërohen nga Shteti Shqiptar të administruara nga Ministria e Ekonomisë, e Tregtisë dhe Energjetikës së Shqipërisë dhe 2.4% zotërohen nga aksionerët e vegjël, punonjës të AMC-s ne kohën e privatizimit.

4. Më 9 qershor 2001, Vodafone, licencohet si operator i dytë i shërbimit celular në Shqipëri (licensa nr.2), me kapital të përbashkët të Vodafone International Holding (51% të aksioneve) dhe Panafone International Holding (49 % të aksioneve).
5. Më 1 mars të vitit 2004 u licencua operatori i tretë, Eagle Mobile (licensa nr 3) me 100% të aksioneve në zotërim të Albtelekom sh.a. Ky operator nuk ka patur veprimtari në treg gjatë gjithë periudhës së hetimit.
6. Në këto kushte në tregun e telefonisë së lëvizshme gjatë periudhës së hetimit kanë vepruar vetëm dy operatorë, shoqëritë nën hetim, AMC dhe Vodafone .

III. Periudha e Hetimit

7. Periudha e marrë në shqyrtim për hetimin në Tregun e telefonisë së lëvizshme përfshin vitet 2004-2005.
8. Për efekt të studimit të sjelljes të shoqërive objekt hetimi dhe nivelit të konkurrencës për një periudhë më të gjatë kohe, Autoriteti i Konkurrencës ka analizuar tregun e telefonisë së lëvizshme nga viti 2001 deri në vitin 2005.

IV. Procedurat e ndjekura gjatë hetimit

9. Procedurat e ndjekura gjatë hetimit janë bazuar në kreun III të ligjit nr. 9121, datë 28.07.2003 “Për Mbrojtjen e Konkurrencës“ dhe Kodin e Procedurave Administrative.
10. Me nismën e tij, Autoriteti i Konkurrencës filloi në Shtator të vitit 2005 një hetim në Sektorin e Telefonisë së Lëvizshme. Shkak për fillimin e këtij hetimi u bënë shqetësimi i opinionit publik për çmime të larta në Tregun e Telefonisë Celulare, i prononcuar në mediane shkruar dhe elektronike, kryesisht nga shoqatat dhe institucionet përfaqësuese të mbrojtjes së interesave të konsumatorëve (Shoqata e Mbrojtjes së Konsumatorëve, Avokati i Popullit, etj.) Ky shqetësim është bërë evident në Rekomandimet e Unionit Ndërkombëtar të Telekomunikacioneve (ITU).³⁷

³⁷ ERT të nisë një inspektim të marrëveshjes së interkoneksionit ndërmjet Albtelekomit nga njëra anë dhe AMC dhe Vodafon nga ana tjetër, pasi këto marrëveshje në formën aktuale dhunojnë Aktin e Telekomunikacionit dhe dëmtojnë interesat publike.

11. Komisioni i Konkurrencës, pasi administroi dhe shqyrtoi dokumentacionin e depozituar nga Sekretariati dhe pretendimet e dy operatorëve në këtë treg, AMC dhe Vodafone, gjykoj se mund të kishte kufizime të konkurrencës në këtë treg.
12. Me Vendimin e tij nr. 21, date 11.10.2005 Komisioni vendosi “Për nisjen e procedurës së hetimit të thelluar në tregun e telefonisë së lëvizshme në përgjithësi dhe veçanërisht në shoqëritë AMC sh.a dhe Vodafone Sh.a, përse i përket ekzistencës ose jo të abuzimit me pozitën dominuese ose shkelje të tjera të konkurrencës në këtë treg”
13. Në bazë të vendimit nr. 21, date 11.10.2005 të Komisionit të Konkurrencës, Sekretariati ka kryer procedurat hetimore në përputhje me ligjin nr 9121 “Për Mbrojtjen e Konkurrencës” dhe Kodin e Procedurave Administrative. Në përfundim të këtij hetimi, Sekretariati ka paraqitur pranë Komisionit të Konkurrencës “Raportin e Hetimit të Thelluar”. Në bazë të nenit 47 të K.Pr.A., shoqërive nën hetim, AMC dhe Vodafone u janë vënë në dispozicion raporte të veçanta duke hequr nga raporti përfundimtar të dhënat konfidenciale të palëve.
14. Në zbatim të nenit 39, të ligjit 9121, datë 28.07.2003 “Për Mbrojtjen e Konkurrencës”, palët kanë dhënë pretendimet e tyre mbi Raportin e Hetimit të Thelluar në seancat dëgjimore të mbajtura, përkatësisht më 7 qershor 2007 për AMC dhe më 13 qershor 2007 për Vodafone.

V. Pretendimet e palëve

15. Seancat dëgjimore të datave 7 dhe 13 qershor 2007 u zhvilluan në përputhshmëri të plotë me nenin 39 të Ligjit 9121, datë 28.07.2003 “Për Mbrojtjen e Konkurrencës”. Në këto seanca shoqëritë e Tregut të Telefonisë së Lëvizshme perkatesisht AMC dhe Vodafone paraqiten pretendimet e tyre në lidhje me Raportin e Hetimit të Thelluar për këtë treg të hartuar nga Sekretariati i Konkurrencës.

VI.A.Treg përkatës i produktit

16. Treg përkatës i produktit është shërbimi publik i telefonisë së lëvizshme, që ofrojnë secila nga të dy kompanitë celulare AMC dhe Vodafone, ose mundësimi dhe transmetimi i thirrjeve telefonike që ato kryejnë për përdoruesin fundor të tyre (të gjeneruar nga ky përdorues, apo me destinacion këtë përdorues). Në këtë përcaktim është pasur në konsideratë shërbimi i telefonisë së lëvizshme, vetëm në kuptimin e thirrjeve zanore.
17. Tregu përkatës është analizuar edhe me nëndarjet e tij sipas shërbimeve që ofrojnë operatorët, pasi efekti i këtij tregu është më i ndjeshëm në nivelin e konkurrencës dhe i drejtpërdrejtë për ndikimin që ai jep mbi konsumatorin:
 - Parapagim;
 - Kontratë (privatë dhe biznes);

VI.B.Tregu gjeografik

18. Treg gjeografik i shërbimit të telefonisë së lëvizshme të kompanive AMC dhe Vodafone është territori i Republikës së Shqipërisë. Në bazë të licencave individuale, me të cilat operatorët AMC dhe Vodafone Albania operojnë, ato ofrojnë shërbimet e tyre, vetëm në territorin e Republikës së Shqipërisë.

VII. Vlerësimi i Pozitës Dominuese

19. “Pozite dominuese është pozita e një ose me shumë ndërmarrjeve, që i lejon ato të jenë të afta të veprojnë, përsa i takon ofertës, kërkesës, në mënyrë të pavarur nga pjesëmarrësit e tjerë në treg si : konkurrentët, klientët ose konsumatorët”³⁸.
20. Kjo dispozitë është e bazuar edhe në referencat e legjislacionit evropian të lidhura me nenin 82 të Traktatit të BE-së, si dhe konfirmohet nga përkufizimi i Pozitës Dominuese të dhënë nga Gjykata Evropiane e Drejtësisë e Luksemburgut (e cila shqyrton çështjet që lidhen me Konkurrencën), në një nga vendimet e saj si më poshtë:
“ ... një pozite fuqie ekonomike që i jep mundësi një ndërmarrje të pengojë mbajtjen e një konkurrence efektive në tregun përkatës, duke e lejuar atë të silltet në mënyrë mjaft të pavarur përkundrejt konkurrentëve të saj dhe klientëve dhe së fundi përkundrejt konsumatorëve”³⁹.
21. Duke u bazuar në nenin 8 të Ligjit nr 9121, datë 28.07.2003 “Për Mbrojtjen e Konkurrencës“, pozita dominuese e një ose më shumë ndërmarrjeve vlerësohet, duke marrë parasysh veçanërisht:

VII.A. Pjesët e tregut përkatës të shoqërive AMC dhe Vodafone

22. Bazuar në nenin 8 të Ligjit nr.9121, datë 28.07.2003, “Për Mbrojtjen e Konkurrencës” dhe pjesës së tregut që zënë ndërmarrjet në tregun e , i cili pikërisht nga rëndësia është renditur i pari në nenin 8 të Ligjit nr. 9121, datë 28.07.2003 “Për Mbrojtjen e Konkurrencës”.
19. Nga ndarja e tregut në tërësi, rezulton se shoqëritë AMC dhe Vodafone zotërojnë pjesë tregu, pothuajse të barabarta për periudhën 2004-2005, duke krijuar një ndarje simetrike të tregut,

VII.B. Pengesat në hyrjen në treg (administrative, teknike dhe ekonomike)

23. Tregu i telefonisë së lëvizshme në Shqipëri është i rregulluar nga institucione publike⁴⁰. Institucioni i ngarkuar për rregullimin e tregut të telekomunikacioneve në Republikën e Shqipërisë është Enti Rregullator i Telekomunikacioneve (ERT).
24. Pengesat në hyrje janë faktorë të cilët i pengojnë operatorët e rinj të hyjnë në një treg të caktuar. Këto mund të jenë administrative, teknike dhe ekonomike.

Barrierat administrative

25. Në Shqipëri, numri i licencave është kufizuar në bazë të akteve nënligjore dhe më konkretisht me Vendim të Këshillit të Ministrave (“Qeveria angazhohet të hapë sektorin e telekomunikacioneve për konkurrencë nëpërmjet lejimit të pjesëmarrjes së interesave

³⁸ Ligji nr 9121, datë 28.07.2003 “Për Mbrojtjen e Konkurrencës” neni 3, pika 5.

³⁹ Çështja 27/76, datë 14.09.1978 United Brands v Commission.

⁴⁰ Barrierat ligjore ose rregullatore nuk bazohen në kushte ekonomike, por rezultojnë nga masa shtetërore legjislative, administrative ose të tjera, që kanë një efekt direkt mbi kushtet e hyrjes dhe/ose pozicionimin e operatorëve në tregun përkatës (Rekomandimi i Komisionit Evropian i datës 11.02.2003 “Për produktin përkatës dhe tregun e shërbimeve në sektorin e komunikimeve elektronike”).

private. Edhe me hapjen e plotë të tregut të telekomunikacioneve për konkurrencë, disa shërbime do të vazhdojnë të ekzistojnë në këtë kategori ku numri i licencave është i kufizuar, për shkak të burimeve të kufizuara natyrore siç janë frekuencat⁴¹. Kjo shpreh mjaft qarte faktin se kemi të bëjmë me një treg ku ekzistojnë barrierat hyrëse administrative).

Barrierat teknike

26. Spektri i radiofrekuencave është një burim natyror i kufizuar,⁴² ndërkohë që plani kombëtar i radiofrekuencave ose ndryshimi i tij miratohet nga Këshilli i Ministrave. Për ushtrim normal të një veprimtarie teknike në këtë treg është e nevojshme që një shoqëri e licensuar në këtë treg të ketë në dispozicion mesatarisht 40-50 radiofrekuenca në bandën 900Mhz dhe rreth 80-100 radio frekuenca në bandën 1800 Mhz. Shqipërisë i janë lënë në dispozicion nga Rrjeti Europian i Telekomunikacionit rreth 174 radiofrekuenca në bandën 900 Mhz dhe rreth 384 në bandën 1800 Mhz.

Barrierat ekonomike

27. Operatorët për tu futur në tregun e telefonisë së lëvizshme, duhet të kryejnë investime të mëdha, si për blerjen e licencës, ashtu edhe për ndërtimin e rrjetit të tij të telefonisë celulare, që do të thotë se këto përbëjnë barrierat ekonomike për operatorët e rinj për të hyrë në treg.
28. Operatorët ekzistues, AMC dhe Vodafone, kanë krijuar avantazhe të konsiderueshme në tregun e telefonisë celulare. Ato kanë krijuar rrjetet e tyre, klientët përkatës (abonentët), eksperiencë në menaxhimin e tregut, emër nëpërmjet marketingut, si dhe fuqi të konsiderueshme ekonomike dhe financiare. Në këto kushte, operatorëve të rinj do tu duhet kohë dhe mjete monetare të konsiderueshme, për tu bërë pjesë efektive e këtij tregu. Numri i abonentëve potencialë të mbetur në treg është relativisht i kufizuar. Për të siguruar një nivel konkurrues të pranueshëm, këta operatorë të rinj do të duhet t'i marrin përdoruesit e shërbimeve të tyre nga operatorët ekzistues, proces i vështirë për shkak të epërsive që kanë këta të fundit. Ky proces padyshim që përbën një barrierë të konsiderueshme për operatorët e rinj, që duan të futen në treg.
29. Avantazh për operatorët AMC dhe Vodafon përbën edhe fakti që operatori i tretë i licensuar në mars të vitit 2004, Eagle Mobile, nuk e ka ushtruar aktivitetin e tij gjatë periudhës objekt hetimi

VII.C. Konkurrenca potenciale

30. Nga analiza e tregut të telefonisë së lëvizshme rezulton se, për periudhën 2004-2005, konkurrenca në tregun e telefonisë ka qenë e ulët. Kjo ka ardhur kryesisht nga mungesa e operatorëve të tjerë në treg, për shkak të barrierave të larta hyrëse.
31. Eagle Mobile nuk ka ushtruar aktivitet gjatë periudhës objekt hetimi. Në këtë mënyrë kjo shoqëri nuk ka ushtruar ndonjë fuqi kundërvepruese ndaj shoqërive AMC dhe Vodafon, duke mos krijuar asnjë efekt në konkurrueshmërinë e tregut.

⁴¹ Politika e Zhvillimit të Telekomunikacioneve në Republikën e Shqipërisë, miratuar me Vendimin nr 288, datë 18.06.1999 dhe i ndryshuar (1999, 2001, 2002, 2003)

⁴² Po aty, neni 69.

VII.D. Karakteristika të tjera të tregut

32. Produkti përkatës në tregun e telefonisë së lëvizshme është homogjen;
33. Kërkesa në tregun e telefonisë së lëvizshme në Shqipëri ka qenë e qëndrueshme⁴³.
34. Kosto në tregun e telefonisë së lëvizshme në Shqipëri, është uniforme, prej teknologjisë gati të njëjtë të produktit të këtij tregu, por edhe për kushtet e përafërta që kanë shoqëritë AMC dhe Vodafone.
35. Nisur nga pjesët e tregut, pengesat e hyrjes në treg, konkurrenca potenciale, fuqia ekonomike e ndërmarrjeve, fuqia kundërvepruese e blerësve dhe karakteristikat e tjera të tregut, rezulton se në mbështetje të nenit 8 të Ligjit nr. 9121 datë 28.07.2003 “Për Mbrojtjen e Konkurrencës”, kompanitë **AMC dhe Vodafone kanë pozitë dominuese në tregun e telefonisë së lëvizshme.**

VIII. Sjellja e ndërmarrjeve në treg

36. Të dyja shoqëritë AMC dhe Vodafone, nuk kanë zbatuar Vendimin Nr. 179, datë 07.05.2004 të ERT-së, me anë të të cilit ajo vendosi të rekomandojë tarifën e terminimit kombëtar për telefoninë e lëvizshme prej 22 lekë/minutë. Kjo do të thotë që tarifa e terminimit kombëtar në tregun e telefonisë së lëvizshme të ishte jo më i lartë se 22 lekë/minutë për vitin 2004 dhe jo më e lartë se 28 lekë/minutë për 2005. Komisioni i Konkurrencës çmon që ky çmim pasqyrore në atë kohë tarifën e një tregu me konkurrencë efektive.
37. Ulja e tarifave të terminimit me marrëveshje në nivelin 28 lekë/minutë në fund të vitit 2004 nuk ka ndikuar në uljen e tarifave të produktit përkatës për të dy kompanitë, AMC dhe Vodafon, gjatë periudhës objekt hetimi.
38. Të dyja shoqëritë, AMC dhe Vodafone, kanë aplikuar tarifë terminimi kombëtar mbi dy herë më të lartë, krahasimisht me tarifën mesatare të terminimit të vendeve të rajonit.

IX. Abuzimi i AMC sh.a dhe Vodafone Albania sh.a me Pozitën e tyre Dominuese⁴⁴

39. Bazuar në Ligjin nr 9121, datë 28.07.2003 “Për Mbrojtjen e Konkurrencës”, neni 9, pika 1 “Ndalohet çdo abuzim nga një ose më shumë ndërmarrje me pozitë dominuese në treg” dhe 2, germa a ”Mund të përbëjnë abuzim veçanërisht vendosja, në mënyrë të drejtpërdrejtë ose të tërthortë, e çmimeve të padrejta blerjeje ose shitjeje, ose e kushteve të tjera të padrejta të tregtimit”

⁴³ Rritimi i rritjes së kërkesës në tregun e telefonisë ka qenë mjaft i lartë, për shembull për vitet 2003, 2004,2005 ai ka qenë përkatësisht: 29%, 15% dhe 21%, sipas numërit të abonentve.

⁴⁴ Komisioni i Konkurrencës konstaton që ndërmarrjet që janë në pozitë dominuese nuk mund të kenë të njëjtën shkallë lirie veprimesh (qoftë edhe për te mbrojtur interesat e tyre) kur këto çojnë në forcimin e pozitës së tyre dominuese dhe abuzimin me të. Në lidhje me këtë pikë për të qartësuar se çfarë kihet parasysh më lart po jepet tekstualisht një sentence nga Çështja Deutsche Grammophon GmbH v Metrosh-Grossmarkte : “Ashtu siç del dhe nga sentenca e Gjykatës, ndryshimi i çmimit mund të jetë një tregues vendimtar për një abuzim me pozitën dominuese sipas nenit 86 të Traktatit të Bashkimit Ekonomik Europian, në se ai është i madh dhe i vendosur pa motiv objektiv”. Po kështu dhe në rastin Sirena v Eda-s tekstualisht shprehet : “Atë që kërkon shfrytëzimi abuziv i një pozicioni dominues, këtë abuzim nuk e tregon domosdoshmërisht vetëm çmimi i lartë i prodhimit, por megjithatë ai mund të jetë një tregues vendimtar, kur nuk është i përligjur dhe tepër i lartë, si dhe asnjëherë.”

40. Sipas nenit neni 9, pika 2, gërma a, një ndër format kryesore të abuzimit me pozitën dominuese është zbatimi i çmimeve të padrejta prej tyre (Unfair Pricing ose Excessive Prices)⁴⁵. Çmimi i praktikuar është i padrejtë kur ai është shumë më i lartë se çdo të ishte në një treg konkurrues. Për të vlerësuar karakterin e padrejtë të çmimit, në radhë të parë mund të krahasohet niveli i çmimit me vlerën ekonomike të produktit, ose e thënë ndryshe me koston e tij⁴⁶. Në radhë të dytë, dhe në pamundësi për të patur të disponueshme metodologjinë e përcaktimit të koston (një detyrim ligjor i ERT-së), niveli i çmimit në treg, si dhe norma e fitimit, mund të krahasohet me nivelin e çmimit ose të fitimit të produkteve të krahasueshme apo me çmimin dhe normën e fitimit të të njëjtëve produkte në tregje gjeografike të ndryshme⁴⁷. Sipas rastit dhe informacioneve në dispozicion, mund të përdoren dhe metoda të tjera⁴⁸. Për vërtetimin e abuzimit do të duhet të kalohet në tre teste. Provimi i njërit prej tyre, ose dhe me tepër, do të provonte abuzimin me pozitën dominuese⁴⁹.

XI.A. Vendosja e çmimeve të larta pa lidhje të arsyeshme me vlerën ekonomike të produktit

41. Çmimet e shërbimeve të ofruara nga këto shoqëri, nuk kanë lidhje të arsyeshme me koston përbërëse të tyre. “Vlera ekonomike mund të marrë si orientim koston e produktit, çmimin e mallrave të tjerë të ngjashëm, ose çmimin e një prodhimi të ngjashëm në një territor tjetër”⁵⁰.
42. Po të zbatonin shoqëritë tarifën e terminimit kombëtar prej 22 lekë/minutë të dhënë në Vendimin Nr.179, datë 07.05.2004 të ERT, i cili është konsideruar si banchmark për atë periudhë, si dhe tarifën e terminimit kombëtar 28 lekë/minutë si benchmark për vitin 2005, atëhere tarifata e terminimit fundor kombëtar në llogjikën e formimit të tarifave të pakicës, duhet të reflektonin të paktën me një minimum ndryshimi, fakt i cili nuk është evidentuar gjatë periudhës nën hetim.
43. Nisur nga më lart, Komisioni i Konkurrencës me anë të vendimit nr 59, datë 09.11.2007, është shprehur se shoqëritë AMC sha dhe Vodafone sha kanë abuzuar me pozitën dominuese duke vendosur çmime të padrejta dhe ka vendosur gjobë në masën 2 % të xhiros në tregun përkatës për të dyja shoqëritë.
44. Por ndërkohë, Komisioni i Konkurrencës ka vërejtur se një rol të rëndësishëm në liberalizimin dhe zhvillimin e mëtejshëm të tregut të telekomunikacioneve luajnë edhe institucionet publike nëpërmjet politikave të zhvillimit të telekomunikacionit dhe reformat rregullatore në këtë sektor.

⁴⁵ Në çështjen General Motors, 1975, par. 12, Gjykata e Drejtësisë së KE-së konsideron që: «Abuzimi mund të konsistojë, në veçanti, në vjeljen e një çmimi të ekzagjeruar në raport me vlerën ekonomike të shërbimit të ofruar»; Gjykata e Drejtësisë ka trajtuar gjithashtu në çështjen United Brands, 1978, par. 250 si abuzim«[. . .] praktikën e një çmimi të ekzagjeruar pa lidhje të arsyeshme me vlerën ekonomike të shërbimit të ofruar. »

⁴⁶ Në këtë rast duhet parë «nëse ekziston një diferencë tepër e lartë excessive ndërmjet koston dhe çmimit të kërkuar, dhe nëse kjo vërtetohet, të ekzaminohet nëse ka vendosje çmimi të padrejtë qoftë në nivelin absolut, qoftë duke e krahasuar me produkte konkurrencte » (United Brands, ECJ 1978, paragrafi 252).

⁴⁷ Në çështjen SACEM, çështje të bashkuara 110/88, 241/88 dhe 242/88, 1989, në veçanti në paragrafin 25, Gjykata e Drejtësisë ka konsideruar që: «[...] kur një ndërmarrje në pozitë dominuese vendos tarifa që janë shumë më të larta se tarifata që praktikohen në vendet e tjera anëtare, dhe kur krahasimi kryhen në një bazë homogjene, kjo diferencë duhet konsideruar si shenjë që tregon abuzim të pozitës dominuese.»

⁴⁸ Gjykata e Drejtësisë së KE ka qenë gjithmonë e hapur për metodën e ndjekur për përcaktimin e çmimit të padrejtë. Në çështjen United Brands, 1978, par. 253, ajo konsideron: «mund të konceptohen metoda të tjera – dhe doktrina ekonomike ka konceptuar disa nga këto – për të nxjerrë kriteret e përcaktimit të çmimit të padrejtë të një produkti.»

⁴⁹ Çështja British Leyland v Commission ECR nr 311/84, 3283 (1986)

⁵⁰ Bellamy&Child (2001) “European Community Law of Competition”.

PËR KËTO ARSYE:

Komisioni i Konkurrencës, bazuar në nenin 24, germa f dhe nenin 70, pika 2 të Ligjit Nr. 9121, datë 28.07.2003, “Për Mbrojtjen e Konkurrencës”, me propozim të Sekretariatit,

VENDOSI:

- 1) Ti rekomandojë Këshillit të Ministrave dhe Entit Rregullator të Telekomunikacioneve liberalizimin e tregut të telefonisë së lëvizshme, nëpërmjet hyrjes në treg të operatorit të tretë, “Eagle Mobile” brenda afatit ligjor të parashikuar në kriteret e licencës dhe hapjen e procedurave për një licencë të katërt në tregun e Telefonisë së Lëvizshme, nisur nga radio-frekuencat e lëna në dispozicion në territorin e Shqipërisë.
- 2) Ti rekomandojë ERT-së që dispozitat mbi Operatorët me Fuqi të Ndjeshme në Treg të ligjit nr. 8618, date 14.06.2000 “Për Telekomunikacionet në Republikën e Shqipërisë” të përshtaten me Strukturën Rregullatore për Konumikimet Elektronike të BE-së, sidomos me Direktivat e Vitit 2002. Gjithashtu, Kreu XII që i takon inspektiveve, mbikqyrjes dhe masave administrative duhen rishikuar me synim forcimin e gjobave ndaj kundravajtjeve administrative të kryera nga operatorët.
- 3) Ti Rekomandojë ERT-së, që në kuadrin e zbatimit të detyrimit ligjor sipas nenit 62 të ligjit “Për telekomunikacionet në RSH”, të përgatisë brenda gjysmës së parë të vitit 2008 Metodologjinë e Regullimit të Tarifave të përdoruesve dhe të interkoneksionit të dy operatorëve celularë, të shpallur OFNT.
- 4) T’i rekomandojë Entit Rregullator të Telekomunikacioneve rritjen e transparencës dhe respektimin e parimit e mosdiskriminimit mes operatorëve të tregut të telefonisë për marrëveshjet e interkoneksionit. Gjithashtu Enti Rregullator i Telekomunikacioneve në zbatim të nenit 45 të ligjit “Për telekomunikacionet në RSH” duhet të ndërhyjë që marrëveshjet për interkoneksionin të mos çënojnë parimet e konkurrencës në tregun e telekomunikacioneve.
- 5) Ti rekomandojë ERT-së të fillojë punën për zbatimin e të drejtës së abonentëve për portabilitetin e numrave brenda gjysmës së parë të vitit 2008 në përputhje me “Politikën e Zhvillimit të Telekomunikacioneve” dhe praktikat më të mira të vendeve të rajonit në këtë fushë.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

KOMISIONI I KONKURRENCËS

Lush Përpali

Servete Gruda

Koço Broka

()
Zv/Kryetar()
Anëtar()
Anëtar**Lindita Milo (Lati)****KRYETARE**



**REPUBLIKA E SHQIPËRISË
AUTORITETI I KONKURENCËS
KOMISIONI I KONKURENCËS**

V E N D I M

Nr.62 Datë 26.11.2007

Për njoftimin e përqendrimit “Për transferimin e 70% të kapitalit aksionar në Raiffeisen International Bank-Holding AG, zotëruar nga Raiffeisen Zentral Bank, tek shoqëria Cembra Beteiligungs GmbH”

Komisioni i Konkurrencës me pjesëmarrjen e:

- Znj. Lindita Milo (Lati) Kryetar
- Zt. Lush Përpali zv/kryetar
- Znj. Servete Gruda Anëtar
- Zt. Koço Broka Anëtar

Në mbledhjen e tij të datës 26.11.2007, shqyrtoi çështjen me :

Objekt: Njoftimin e përqendrimit të realizuar nëpërmjet transferimit të pjesës prej 70% të kapitalit aksionar në Raiffeisen International Bank-Holding AG, zotëruar nga Raiffeisen Zentral Bank, tek shoqëria Cembra Beteiligungs GmbH” me Ligjin

Baza ligjore: Ligji Nr. 9121, datë 28.07.2003 “Për Mbrojtjen e Konkurrencës”, neni 24, shkronja d, nenet 10-12, neni 56, Rregullorja “Për zbatimin e procedurave të përqendrimit të ndërmarrjeve” neni 5.

Komisioni i Konkurrencës, pas shqyrtimit të raportit të Sekretariatit mbi njoftimin e përqendrimit të realizuar nëpërmjet transferimit të pjesës prej 70% të kapitalit aksionar në Raiffeisen International Bank-Holding AG, zotëruar nga Raiffeisen Zentral Bank, tek shoqëria Cembra Beteiligungs GmbH.

V Ë R E N S E:

1. Palët e përfshira në mënyrë të drejtëpërdrejtë në transaksion:
 - Raiffeisen Zentral Bank (RZB), me qendër në Vienë, Austri, e autorizuar për ushtrimin e të gjitha veprimtarive bankare dhe financiare, duke u renditur si banka e tretë në tregun e brendshëm, duke u specializuar në korporatat dhe

investimet bankare. RZB ushtron veprimtarinë e saj nëpërmjet rrjetit e vet bankar në Evropën Qëndrore (Çeki, Hungari, Poloni, Sllovaki dhe Slloveni); në Europën Juglindore (Shqipëri, Bosnje-Herzegovinë, Bullgari, Kosovë, Kroaci, Rumani dhe Serbi);

Në shtetet e ish BS (Rusi, Ukrainë, Kazakistan dhe Biellorusi); si dhe në disa vende të tjera si në Londër, Singapor, Maltë, USA, Gjermani dhe Svicër. Ky rrjet i gjërë i përbërë nga degët, filiale të specializuara dhe zyra përfaqësimi në tregjet financiare më të rëndësishme të Europës Juglindore dhe Azisë, manaxhohet nga grupi Raiffeisen International, ku RZB zotëron 70% të kapitalit aksionar.

Në Shqipëri, RZB është e pranishme që nga viti 2004, me blerjen 100% të kapitalit aksionar dhe të së drejtës së votës të Bankës së Kursimeve Sh.A; RZB e ushtron veprimtarinë e saj nëpërmjet degëve të Raiffeisen International Bank Holding AG, të cilën e kontrollon 100%.

Cembra Beteiligungs GmbH, me qendër në Vienë, Austri, është themeluar si shoqëri aksionere në vitin 1968 dhe në bazë të licensës që zotëronte ka ushtruar veprimtari të kufizuar bankare, vetëm për produktin/shërbimin e emetimit të letrave me vlerë. Kjo veprimtari, në një treg produkti të kufizuar, është ndërprerë në qershor të 2004, me dorëzimin e licensës bankare. Prej vitit 2004 deri në 2005 shoqëria Cembra nuk ka kryer veprimtari tregtare. Në 2005, aksioneri i vetëm i shoqërisë “Cembra”, RZB-ja, e shndroi formën e shoqërisë, duke e kthyer atë nga Sh.A në shoqëri me përgjegjësi të kufizuara, veprimtaria ekonomike e së cilës përfshin pjesëmarrjen në shoqëri të tjera, shitjen dhe administrimin e kompanive, manaxhimin e veprimtarive të tyre.

Cembra Beteiligungs GmbH, është pjesë e grupit RZB, i cili e zotëron/kontrollon atë në mënyrë të tërthortë 100%, nëpërmjet aksionerit të vetëm të Cembra-s, RI-BG, i cili vetë zotërohet/kontrollohet 100% nga RZB.

Palët e përfshira në mënyrë të tërthortë në transaksion:

- Raiffeisen International Bank Holding AG(RI) është person juridik i veçantë, me përgjegjësi të kufizuara, që i përket të njëjtit grup - Grupit Ndërkombëtar Raiffeisen dhe që ushtron veprimtari manaxhimi dhe administrimi në banka dhe institucione financiare, për llogari të RZB. Në Shqipëri, RI ushtron veprimtari 100% bankare nëpërmjet Raiffeisen International Albania.
 - Raiffeisen International Albania Sh.a, ushtron veprimtarinë në tregun e produkteve/ shërbimeve bankare në përputhje me licensën e saj.
 - Raiffeisen International Beteiligungs GmbH është shoqëri e zotëruar/kontrolluar 100% nga RZB dhe është aksioneri i vetëm i shoqërisë Cembra. Kjo do të thotë që Cembra është e zotëruar/kontrolluar 100% në mënyrë të tërthortë nga RZB.
2. Drejtimi i shoqërive Cembra dhe RI-BG do të përbëhet nga borde, anëtarët e të cilëve janë njëkohësisht edhe anëtarë të bordit drejtues të RZB-së.
 3. Palët pjesëmarrëse në transaksionin e transferimit janë të integruara vertikalisht dhe kontrollohen nga shoqëria “mëmë” në mënyrë të drejtëpërdrejtë apo të tërthortë.

4. RZB-ja edhe mbas këtij transferimi aksionesh e ruan kontrollin e tyre, por nëpërmjet shoqërisë Cembra, që mbetet e kontrolluar/zotëruar 100% në mënyrë të tërthortë nga RZB.
5. Transferimi e 70% të kapitalit aksionar të zotëruar në RI tek shoqëria Cembra, konsiderohet si ristrukturim, që shërben për manaxhimin sa më efikas të interesave financiare të RZB dhe nuk sjell asnjë ndryshim përsa i përket drejtimit ligjor të shoqërisë (kontrollit, administrimit dhe pronësisë në RI, e cila mbetet aksioneri i vetëm i Raiffeisen International në Shqipëri (RIA), d.m.th nuk është përqendrim në kuptim të nenit 10 dhe 12 të Ligjit.

PËR KËTO ARSYE

Në bazë të nenit 24, shkronja d, dhe nenit 56 pika 1 të Ligjit nr. 9121, datë 28.07.2003 “Për Mbrojtjen e Konkurrencës”, nenit 5 të Rregullores “Për zbatimin e procedurave të përqendrimit të ndërmarrjeve”

VENDOSI:

1. Të mos klasifikojë njoftimin “Për transferimin e 70% të kapitalit aksionar në Raiffeisen International Bank-Holding AG, zotëruar nga Raiffeisen Zentral Bank, tek shoqëria Cembra Beteiligungs GmbH”, si përqendrim në zbatim të neneve 10 dhe 12 të Ligjit Nr. 9121, datë 28.7.2003 “Për Mbrojtjen e Konkurrencës”.
2. Të njoftohet me shkrim pala njoftuese.
3. Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

KOMISIONI I KONKURENCËS

Lush Përpali

Servete Gruda

Koço Broka

(_____)

Zv/Kryetar

(_____)

Anëtar

(_____)

Anëtar

Lindita Milo (Lati)

KRYETARE



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
AUTORITETI I KONKURENCËS
KOMISIONI I KONKURENCËS

V E N D I M

Nr. 63 Datë 03.12.2007

Për vendosje gjobe ndaj Shoqërisë ProCredit Holding AG

Komisioni i Konkurrencës me pjesëmarrjen e:

- Znj. Lindita Milo (Lati) Kryetar
- Zt. Lush Përpali zv/kryetar
- Znj. Servete Gruda Anëtar
- Zt. Koço Broka Anëtar

Në mbledhjen e tij të datës 3.11. 2007, shqyrtoi çështjen me :

Objekt: Pa saktësi në njoftimin e përqendrimit të realizuar nëpërmjet shitblerjes të pjesës në total së 36.25 % të aksioneve në ProCredit Bank Sh.A nga ProCredit Holding A.G.

Baza ligjore: Ligji nr. 9121, datë 28.07.2003 “Për Mbrojtjen e Konkurrencës”, neni 24, shkronja d, neni 73, pika 1, shkronja b, nenet 10-12, në veçanti Kreu IV “Përqendrimet e Ndërmarrjeve” nenet 53-56, 58, neni 80, Rregullorja “Për zbatimin e procedurave të përqendrimit të ndërmarrjeve”, Udhëzimi “Për formën e njoftimit të përqendrimit dhe mundësinë për njoftim të thjeshtuar” dhe Formulari “Për Njoftimin e Përqendrimit”.

Komisioni i Konkurrencës, pas shqyrtimit të raportit të Sekretariatit për përqendrimin e njoftuar, dëgjimit të palëve, përfaqësuar nga ProCredit Bank dhe pas administrimit të shkresës Nr TH3647 Prot të Procredit Bank, datë 16 Nëntor 2007 dhe me Nr 549 Prot, datë 16 Nëntor 2007, të Autoritetit të Konkurrencës,

V Ë R E N S E:

1. Palët në transaksion:
 - ProCredit Holding A.G, blerësi i pjesës prej 36.25% të kapitalit aksionar të ProCredit Bank Sh.A, që përfshin 25% të kapitalit aksionar të FEFAD dhe 11.25% të kapitalit aksionar të IFC-së,

- FEFAD (Fondacioni për financimin dhe zhvillimin e ndërmarrjeve të vogla dhe të mesme private), shitësi, i pjesës prej 25% të kapitalit aksionar të barabartë me 40.000 aksione, me vlerë 2.956.000 Euro,
 - IFC (Korporata Ndërkombëtare Financiare) shitësi i pjesës prej 11.25% të kapitalit aksionar të barabartë me 18.000 aksione, me vlerë 1.330.200 Euro në PCB Sh.a,
në datën 8 qershor 2007, kanë lidhur një marrëveshje për përfitim të kontrollit nga ProcreditHolding AG për 36.25% të kapitalit aksionar, në ProCredit Bank Sh.A.
2. Informacioni i siguruar nga ProCredit bank lidhur me datën e nënshkrimit të marrëveshjes nuk është i saktë dhe nuk është i plotë, duke krijuar mospërputhje me kërkesën për njoftim të përqendrimit të përcaktuar në nenin 12, pika 2 e ligjit 9121 “Për Mbrojtjen e Konkurrencës”.
 3. Veprimi i mësipërm konsiderohet shkelje sipas nenit 73, pika 1, shkronja b.

PËR KËTO ARSYE

Në bazë të nenit 24, shkronja d, nenit 12, pika 2, nenit 55, pika 1, nenit 73 pika 1, shkronja b, neni 80 të Ligjit nr. 9121, datë 28.07.2003 “Për Mbrojtjen e Konkurrencës”

VENDOSI:

1. Gjobë ndaj shoqërisë ProCredit Holding A.G, në shumën 7 237 464 lekë.
2. Në mbështetje të nenit 80 të Ligjit Nr.9121, datë 28.7.2003 “Për Mbrojtjen e Konkurrencës”, Policia Tatimore kryen ekzekutimin e gjobës në shumën e mësipërme.
3. Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

KOMISIONI I KONKURRENCËS

Lush Përpali

Servete Gruda

Koço Broka

()
Zv/Kryetar

()
Anëtar

()
Anëtar

Lindita Milo (Lati)

KRYETARE



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
AUTORITETI I KONKURRENCËS
KOMISIONI I KONKURRENCËS

V E N D I M

Nr. 64 Datë 03.12. 2007

Mbi autorizimin e përqendrimit për përfitim e kontrollit të ProCredit Holding AG në ProCredit Bank Sh.A.

Komisioni i Konkurrencës me pjesëmarrjen e:

- Znj. Lindita Milo (Lati) Kryetar
- Zt. Lush Përpali zv/kryetar
- Znj. Servete Gruda Anëtar
- Zt. Koço Broka Anëtar

Në mbledhjen e tij të datës 03.12.2007, shqyrtoi çështjen me :

Objekt: Autorizimin e përqendrimit të realizuar nëpërmjet shitblerjes të pjesës në total të 36.25 % të aksioneve në ProCredit Bank Sh.A nga ProCredit Holding A.G.

Baza ligjore: Ligji nr. 9121, datë 28.07.2003 “Për Mbrojtjen e Konkurrencës”, neni 24, shkronja d, nenet 10-12, në veçanti Kreu IV “Përqendrimet e Ndërmarrjeve” nenet 53-56, 58, Rregullorja “Për zbatimin e procedurave të përqendrimit të ndërmarrjeve”, Udhëzimi “Për formën e njoftimit të përqendrimit dhe mundësinë për njoftim të thjeshtuar” dhe Formulari “Për Njoftimin e Përqendrimit”, neni 74, shkronja ç.

Komisioni i Konkurrencës, pas shqyrtimit të njoftimit të përqendrimit,

V Ë R E N S E:

4. Banka ProCredit Sh.a është shoqëri anonime, e organizuar dhe që funksionon sipas legjislacionit shqiptar. PCB Sh.A është pjesë e sistemit bankar, e licensuar si bankë, me vendimin nr.12, datë 15.03.1999, nga Banka e Shqipërisë. Selia e saj është në Tiranë dhe ka 21 degë dhe 1 agjensi, duke u shtrirë pothuajse në të gjithë tregun bankar të Shqipërisë së mesme, pjesës juglindore dhe ultësirën perëndimore: Tiranë, Durrës, Fier, Elbasan, Korçë, Shkodër, Lezhë, Lushnje, Pogradec, Sarandë, Berat, Vlorë, Gjirokastrë, Bilisht, Kuçovë dhe Laç.

Kapitali themeltar i PCB Sh.A përbëhet nga 160.000 aksione me vlerë nominale 73.90 Euro secila.

Struktura e PCB Sh.A përbëhet nga 4 aksionerë: ProCredit Holding A.G (43.75%); FEFAD (25%); IFC (11.25%) dhe ComerzBank AG (20%).

Xhiro totale në tregun kombëtar e ProCredit Bank Sh.a. është: 2 894 985 925 lekë.

5. Palët në transaksion:

- ProCredit Holding A.G, blerësi i pjesës prej 36.25% të kapitalit aksionar të ProCredit Bank Sh.A, që përfshin 25% të kapitalit aksionar të FEFAD dhe 11.25% të kapitalit aksionar të IFC-së, është shoqëria kryesore e grupit me të njëjtin emër, që funksionon në përputhje me legjislacionit gjerman. Selia e saj është në Kischwaldstrabe 19, 60435 Frankfurt Am Main, Gjermani. Kjo shoqëri, sipas rregjistrimit tregtar të gjykatës së Frankfurtit, është e autorizuar të marrë pjesë në institucione financiare të vendeve në zhvillim dhe ekonomive në transformim, të mbështesë dhe të drejtojë të gjitha institucionet tek të cilat ProCredit Group ka investuar, duke influencuar në politikën e tyre të biznesit, si dhe të njohë dhe të mbrojnë interesat e aksionerëve të pakicës në të gjitha institucionet ku ajo investon. PCH AG zotëron mazhorancën e aksioneve në 23 institucione financiare dhe indirekt ka kontrollin mbi politikat e biznesit edhe në 4 institucionet e tjera të grupit PCH.

Në tregun shqiptar, kjo shoqëri ushtron veprimtari bankare nëpërmjet PCB Sh.a, ku zotëron 43.75% të kapitalit aksionar të barabartë me 70.000 aksione, me vlerë 5.173.000 Euro;

Për vitin 2006, Xhiro totale në tregun ndërkombëtar e ProCredit Holding AG është: 259.675.000 Euro= 31.940.025.000 lekë.

- Fondacioni për financimin dhe zhvillimin e ndërmarrjeve të vogla dhe të mesme private (FEFAD), shitësi, i pjesës prej 25% të kapitalit aksionar të barabartë me 40.000 aksione, me vlerë 2.956.000 Euro, me seli në Tiranë, është organizuar dhe funksionon sipas legjislacionit shqiptar, themeluar në gusht 1995 sipas ligjit për Shoqëritë Tregtare. Aktualisht, fondacioni nuk kryen veprimtari ekonomike, përveç pjesëmarrjes si aksioner/zotërues i 40.000 aksioneve në PCB Sh.a.
- Korporata Ndërkombëtare Financiare (IFC) shitësi i pjesës prej 11.25% të kapitalit aksionar të barabartë me 18.000 aksione, me vlerë 1.330.200 Euro në PCB Sh.a., është pjesë e grupit të Bankës Botërore, e krijuar nga shtetet anëtare të saj, me seli në Uashington D.C, USA. Qëllimi i këtij institucioni, sipas marrëveshjes së lidhur ndërmjet shteteve anëtare të saj është nxitja e zhvillimit ekonomik duke inkurajuar përhapjen e bizneseve prodhuese private, veçanërisht në zonat më pak të pazhvilluara. IFC është aksioner/zotërues i 18.000 aksioneve në kapitalin aksionar të ProCredit Bank Sh.A;

në datën 8 qershor 2007, kanë lidhur një marrëveshje për përfitim të kontrollit nga ProcreditHolding AG për 36.25% të kapitalit aksionar, në ProCredit Bank Sh.A.

Kjo marrëveshje është njoftuar në Autoritetin e Konkurrencës në datën 16.8.2007, jashtë afatit 1 javor të njoftimit të përcaktuar në nenin 12, pika 2 e ligjit 9121 "Për Mbrojtjen e Konkurrencës".

6. Transaksioni i njoftuar konsiston në përftimin e kontrollit prej 36.25% të aksioneve në Bankën ProCredit Bank Sh.A, që i përket respektivisht 25% dhe 11.25% FEFAD dhe IFC, nga ProCredit Holding A.G., duke mundësuar përftimin e kontrollit mazhoritar në kapitalin aksionar dhe në të drejtën e votës të aksionerëve në masën 80%., nga kjo e fundit.

Pjesa prej 20% të aksioneve të mbetura të kapitalit aksionar të ProCredit Bank Sh.A që përfaqësojnë 32.000 aksione do të zotërohen nga CommerzBank.

7. Ky transaksion, përbën përftimin e kontrollit të 80% të kapitalit aksionar dhe të së drejtës së votës dhe është një përqendrim që përmbush kushtet për të qenë subjekt i shqyrtimit nga Autoriteti i Konkurrencës në përputhje me nenin 12, pika 1/a dhe b e Ligjit.

Vlerësimi i Konkurrencës

8. TREGU PËRKATËS

Referuar nenit 3, pika 7, të Ligjit, përcaktimi “treg përkatës”, përfshin dy komponentë:

- a) tregu i produktit, dhe
 - b) tregu gjeografik.
- 5.a. Tregu i produktit:
- a) Pranimin dhe grumbullimin e depozitave bankare;
 - b) Dhënie kredish;
 - c) Marrje hua të mjeteve financiare dhe blerje ose shitje për llogari të saj a për llogari të klientëve:
 - i) instrumente të tregut të parave;
 - ii) letrat me vlerë të borxhit;
 - iii) kontratat e “së ardhmes“ dhe kontratat me kusht “option“, që lidhen me letrat me vlerë të borxhit ose normat e interesit; ose që lidhen me letrat me vlerë të borxhit ose me normat e interesit; ose
 - vi) instrumentet e normës së interesit.
 - ç) Të ofrojë shërbimin e pagesave dhe të arkëtimeve;
 - d) Të emetojë, të pranojë dhe të administrojë mjete të pagesave;
 - e) Të ndërmjetësojë për transaksione monetare, përfshirë valutat;
 - f) Të ushtrojë qeranë financiare;
 - g) Të ofrojë shërbimin e kasave të sigurimit;
 - h) Të ofrojë garanci bankare dhe garanci të tjera;
 - i) Të shërbejë si agjent ose këshilltar financiar (nuk përfshihen shërbimet që përshkruhen në shkronjat a dhe b.

Pjesa e tregut e zotëruar nga ProCredit Bank Sh.A në tregun e depozitave, bonove të thesarit, kredive etj., respektivisht është:

- a. 4.11% të tregut të bonove të thesarit
- b. 5.37 % të totalit të depozitave
- c. 5.95 % të tregut të kredisë
- d. 4.51 % të tregut të aseteve

5.b Tregu Gjeografik:

Tregu gjeografik i PCB Sh.A i përbërë nga 21 degë, konsiderohet si një treg i lokalizuar në disa Qarqe, brenda tregut kombëtar. Por, duke u nisur nga tendenca e bankave për të zgjeruar rrjetin e tyre dhe për të ofruar shërbime me teknologji më të lartë, zgjerim për të cilin nuk ekziston asnjë pengesë administrative dhe ligjore, potencialisht në vlerësimin e këtij përqendrimi, tregu përkatës gjeografik është konsideruar Tregu kombëtar.

Theksojmë se megjithëse palët pjesëmarrëse në përqendrim ushtrojnë veprimtarinë e tyre në të njëjtin nivel tregu të produktit dhe gjeografik, ato nuk kontrollojnë apo nuk kontrollohen nga njëra tjetra as horizontalisht as vertikalisht.

9. Konkurrentët në tregun kombëtar

A. Në tregun shqiptar ushtrojnë veprimtarinë e tyre në total 17 banka të nivelit të dytë. Burimi i kapitalit vjen nga vende të ndryshme si p.sh, Shqipëria, Greqia, Italia, Gjermania, Franca, Sh.B.A, Bullgaria etj. Në treg veprojnë dy banka me kapital vendas, Credins dhe Union Bank. Ndërsa dy banka të tjera janë me kapital vendas dhe të huaj (Banka e Bashkuar e Shqipërisë ku raportet mes kapitalit të huaj dhe vendas janë 60 me 40 % dhe Banka Popullore ku raporti respektivisht është 75 me 25 % në favor të kapitalit të huaj-Societe Generale dhe 12 banka të tjera me kapital 100% të huaj, ku më e madhja është Raiffeissen International Bank.

Konkurrentët kryesorë të ProCredit Bank Sh.A në tregjet kryesore të produkteve (depozita, kredi, bono thesari), janë: Raiffeissen International Bank, BKT, ABA, Banka Popullore etj.

B. Tregu bankar është i hapur për konkurrencë, pa barriera hyrëse dhe mbikqyret nga Banka e Shqipërisë.

Në përfundim, ky transaksion konsiston në përfitim të kontrollit të paketës kontrolluese prej 80% të aksioneve në PCB Sh.a, nga ProCredit Holding AG, duke reduktuar numrin e aksionerëve dhe forcuar pozitën dominuese të ProCredit Holding AG, nuk shkakton ndryshime të PCB SH.A në raport me konkurrentët e tjerë të tij, që ushtrojnë veprimtari si brenda grupit G 2 dhe më gjërë në tregun bankar. Ky transaksion nuk sjell asnjë ndryshim në strukturën e tregut bankar.

Në këtë kontekst përqendrimi nuk ka efekte anti konkurruese në tregun bankar, në kuptimin e nenit 13, pika 1 e Ligjit, pasi nuk forcon apo krijon pozitë dominuese në tregun bankar.

PËR KËTO ARSYE

Në bazë të nenit 24, shkronja d, dhe nenit 56 pika 1 të Ligjit nr. 9121, datë 28.07.2003 “Për Mbrojtjen e Konkurrencës”

VENDOSI:

1. Të autorizojë, përqendrimin e realizuar nëpërmjet blerjes së pjesës 36.25% të aksioneve në PCB Sh.a në Shqipëri nga ProCredit Holding A.G, me qendër në Frankfurt, Gjermani.
2. Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

KOMISIONI I KONKURENCËS

Lush Përpali

Servete Gruda

Koço Broka

(_____)
Zv/Kryetar(_____)
Anëtar(_____)
Anëtar**Lindita Milo (Lati)**

K R Y E T A R E



**REPUBLIKA E SHQIPËRISË
AUTORITETI I KONKURENCËS
KOMISIONI I KONKURENCËS**

V E N D I M

Nr.65. Datë 11.12.2007

Mbi

Autorizimin e përqendrimit të Bankës Amerikane të Shqipërisë me Bankën Italo-Shqiptare

Komisioni i Konkurrencës me pjesëmarrjen e:

- Znj. Lindita Milo (Lati) Kryetar
- Zt. Lush Përpali zv/kryetar
- Znj. Servete Gruda Anëtar
- Zt. Koço Broka Anëtar

Në mbledhjen e tij të datës 11.12.2007, shqyrtoi çështjen me:

Objekt: Autorizimin e përqendrimit të realizuar nëpërmjet bashkimit të Bankës Amerikane të Shqipërisë dhe Bankës Italo Shqiptare.

Baza ligjore: Ligji Nr. 9121, datë 28.07.2003 “Për Mbrojtjen e Konkurrencës”, neni 24, shkronja d, nenet 10-12, në veçanti Kreu III “Përqendrimet e Ndërmarrjeve” nenet 53-56, 58, Rregullorja “Për zbatimin e procedurave të përqendrimit të ndërmarrjeve”, Udhëzimi “Për formën e njoftimit të përqendrimit dhe mundësinë për njoftim të thjeshtuar” dhe Formulari “Për njoftimin e Përqendrimit”.

Komisioni i Konkurrencës, pas shqyrtimit të raportit të Sekretariatit mbi “Njoftimin e përqendrimit të realizuar nëpërmjet bashkimit të Bankës Amerikane të Shqipërisë me Bankën Italo-Shqiptare”

V Ë R E N S E:

1. Palët në transaksion:
 - Banka Amerikane e Shqipërisë (BAA), me seli në Tiranë, Shqipëri është shoqëria aksionere, e përbërë nga dy aksionerë:

- a) Intesa Sanpaolo S.p.a, zotëruesi i pjesës prej 80% të aksioneve; dhe
- b) Fondi Shqiptaro-Amerikan i Ndërmarrjeve (AAEF), zotërues i pjesës prej 20% të aksioneve.
 - Banka Italo Shqiptare (BIA), me seli në Tiranë, Shqipëri, është shoqëria aksionere, e përbërë nga tre aksionerë:
 - a) Intesa Sanpaolo S.p.a, zotëruesi i pjesës prej 76.13 % të aksioneve;
 - b) Banka Evropiane për Rindërtim dhe Zhvillim (BERZH), zotërues i pjesës prej 20% të aksioneve: dhe
 - c) Simest S.p.a, zotërues i 3.87 % të aksioneve;

në 6 Nëntor 2007 kanë lidhur një Marrëveshje, e cila konsiston në bashkimin e Bankës Italo Shqiptare me Bankën Amerikane të Shqipërisë. Si pasojë, BIA pushon së ekzistuari si person juridik dhe të gjitha asetet, detyrimet, si dhe të gjitha marrëveshjet e marrëdhëniet ku BIA është palë, do transferohen sipas ligjit tek BAA.

2. BAA dhe BIA ushtrojnë veprimtari bankare dhe financiare, sipas licencave respektive Nr. 11, datë 10.08.1998 dhe Nr. 1/1996, datë 17.07 1998 lëshuar nga Banka e Shqipërisë.
3. Ky transaksion është një përqendrim që përmbush kushtet për të qenë subjekt i shqyrtimit nga Autoriteti i Konkurrencës në përputhje me nenin 10, pika 1 germa a dhe nenin 12, pika 1, germa b e Ligjit.
4. Për vitin 2006, xhiro në tregun ndërkombëtar e:
 - BAA është: 497.285 mijë/lekë;
5. Për vitin 2006, xhiro totale në tregun kombëtar është 5.468.801 mijë/lekë dhe përbëhet nga:
 - Xhiro e BAA-së : 4.201.381 mijë lek; dhe
 - Xhiro e BIA-s : 1.267.420 mijë lek
6. Tregu Përkatës
 - b) Tregu i produktit:

Referuar Licencave të dy bankave dhe anekseve bashkëlidhur janë konsideruar produkte:

 1. Pranimi i depozitave bankare (në formën e depozitave pa afat, me afat ose formave të tjera të depozitave), për të cilat paguan ose jo interes;
 2. Dhënie kredish, duke përfshirë kredi konsumatore dhe hipotekare, faktoringun me ose pa burime ndihme dhe financimin e transaksioneve tregtare;
 3. Marrje hua të mjeteve financiare dhe blerje ose shitje për llogari të saj a për llogari të klientëve (të instrumenteve të tregut të parave si çequet, kambialet dhe certifikatat e depozitave; të letrave me vlerë të borxhit; të kontratave të “së ardhmes“ dhe kontratat “e mundësive“ që lidhen me letrat me vlerë të borxhit ose normat e interesit; të instrumenteve të normës së interesit);
 4. Kryerjen e shërbimeve të pagesës;
 5. Emetimin dhe administrimin e mjeteve të pagesës, duke përfshirë pagesat me kartë, me çequet e udhëtarit dhe çequet e bankierit;

6. Ndërmjetësinë për transaksione monetare, përfshirë valutat;
 7. Lisingu financiar;
 8. Kryerja e shërbimeve si agjent financiar ose këshilltar financiar (nuk përfshihen shërbimet që përshkruhen në pikën 1 dhe 2),
- c) Tregu gjeografik.

Referuar shtrirjes së rrjetit të të dyja bankave pjesëmarrëse në bashkim, vërejmë se ai është një treg i kufizuar, me karakter lokal dhe përqendrimi i tij është më i lartë në Shqipërinë e mesme, Ultësirën perëndimore dhe Ultësirën juglindore.

- BIA ushtron veprimtarinë si bankë nëpërmjet selisë qendrore në Tiranë dhe 5 agjencie në: Tiranë, Durrës, Shkodër dhe Vlorë.
- BAA, ushtron veprimtari në fushën bankare nëpërmjet 10 degëve dhe 11 agjencie në: Tiranë, Durrës, Vlorë, Elbasan, Fier, Lushnje, Gjirokastër, dhe Korçë.

Për vlerësimin e këtij përqendrimi tregu përkatës gjeografik është konsideruar Tregu kombëtar, mbasi efektet nga fuqizimi i pozicionit në treg të bankës së re BAA do të ndihen në tërësinë e tregut bankar.

7. Vlerësimi i ndikimit në konkurrencë:

- Transaksioni konsiston në bashkimin, sipas procedurës së përthithjes së BIA-s nga BAA-ja. Në përfundim të këtij transaksioni, krijohet banka e re BAA (nuk ndryshon emrin) dhe BIA pushon së ekzistuari si person juridik dhe të gjitha asetet, detyrimet, si dhe të gjitha marrëveshjet e marrëdhëniet ku BIA është palë, do transferohen sipas ligjit tek BAA.
- Ndërmarrjet pjesëmarrëse në përqendrim ushtrojnë veprimtari bankare në të njëjtin nivel horizontal të tregut të produktit. Pjesa e tregut e bankës së re BAA pas përqendrimit për vitin 2006 do të ishte: 16.44 % të tregut bankar të aseteve, 16.05 % të tregut të kredisë, 7.05 % të tregut të bonove të thesarit dhe 14.35 % të tregut të depozitave, duke e renditur kështu BAA-në në vend të dytë pas Raiffeisen Bank.
- Tregu është i hapur për konkurrencë, pa barriera hyrëse dhe karakterizohet nga ndryshime të shpejta për sa i takon shtrirjes gjeografike dhe ofrimit të produkteve të reja. Tendencat pozitive në zgjerimin e tregut bankar me degë dhe agjenci ka sjellë përmirësimin në mënyrë të dukshme të mbulimit dhe rritjes së cilësisë për produktet ekzistuese dhe atyre të reja dhe kjo, më e theksuar për qytetin e Tiranës.
- Ky përqendrim sjell ndryshime në strukturën e tregut bankar, duke ulur numrin e konkurrentëve (nga 17 në 16 banka) dhe duke forcuar pozicionin në treg të bankës së re BAA, që do të jetë e dyta në renditje në tregun e produkteve (aseteve, kredisë, depozitave, bonove të thesarit).
- Forcimi i pozicionit në treg të bankës së re BAA pas përqendrimit, nuk e kufizon ndjeshëm konkurrencën në treg dhe sjell përfitime për klientët. Futja e shërbimeve/produkteve të reja, përmirësimi i atyre ekzistuese, nga ulja e shpenzimeve dhe rritja e të ardhurave, zhvillimi i teknologjive të informacionit, etj., janë tregues pro-konkurrues që tejkalojnë pasojat që rrjedhin nga forcimi i pozicionit në treg të BAA-së.

PËR KËTO ARSYE

Në bazë të nenit 24, shkronja d, dhe nenit 56 pika 1 të Ligjit nr. 9121, datë 28.07.2003 “Për Mbrojtjen e Konkurrencës”

VENDOSI:

1. Të autorizojë përqëndrimin e realizuar nëpërmjet bashkimit të Bankës Amerikane të Shqipërisë me Bankën Italo Shqiptare.
2. Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

KOMISIONI I KONKURRENCËS

Lush Përpali

Servete Gruda

Koço Broka

(_____)
Zv/Kryetar(_____)
Anëtar(_____)
Anëtar**Lindita Milo (Lati)**

K R Y E T A R E



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
AUTORITETI I KONKURENCËS
KOMISIONI I KONKURENCËS

V E N D I M

Nr.66, datë 18/12/2007

Për Vendosje gjobe për Shkelje të Lehtë

Komisioni i Konkurrencës me pjesëmarrjen e:

- Znj. Lindita Milo (Lati) Kryetar
- Zt. Lush Përpali zv/kryetar
- Znj. Servete Gruda Anëtar
- Zt. Koço Broka Anëtar

Në mbledhjen e tij të datës 18 / 12 /2007, shqyrtoi çështjen me:

Objekt: Përcaktimin e masës së gjobës për ndërmarrjet prodhuese të betonit që nuk kanë sjellë informacionin e kërkuar nga Sekretariati i Autoritetit të Konkurrencës.

Baza ligjore: Ligji nr 9121, datë 28.07.2003 “Për Mbrojtjen e Konkurrencës”, neni 24, neni 33 pika 1, neni 73, pika 1, germa, a) dhe neni 80.
 Kodi i Procedurave Administrative.

Palët të cilave i është kërkuar informacion:

1. **“Alba-Beton” sh.p.k.**, Rr.“Arkitekt Sinani”, Pall 220/1, no. 7, Tiranë
2. **“ANI” sh.p.k.**, Rr. “Qemal Stafa”, Nr 31 Tiranë
3. **“Alban-Tirana Co” sh.p.k.**, Rr.“Komuna e Parisit”, Pall 4, Kati 2 Tiranë.
4. **“Beton Ekspres”**, Pranë fabrikës së tullave Vorë, Tiranë.
5. **“Delia Group “sh.p.k.**, Rr.”Irfan Tomini” Nr. 7 Tiranë.
6. **“Eurovini” sh.p.k.**, Rr “Ismail Qemali” Tiranë
7. **“Eurobeton 2005” sh.p.k.**, Km.1, Autostrada Tiranë – Durrës.
8. **“Euro Lines” sh.p.k.**, Kthesa Kamzës Tiranë.
9. **“Ferro Beton & Construction Co” sh.p.k.**, Km. 20 Vorë, Tiranë
10. **“Halili” sh.p.k.**, Rr. “Qemal Stafa” pranë porcelanit, Tiranë.
11. **“Ital-Beton Construction”**, Lundër, Tiranë.

12. **“Kirchberger Albania” sh.p.k.**, Bul: “Zogu i Parë” Tiranë.
13. **“K.D.K” sh.p.k.**, Rr. “Dervish Hima”, Kulla Nr.1, Tiranë
14. **“Qarri 02” sh.p.k.**, Zall Herr, Tiranë
15. **“Sina 98” sh.p.k.**, Shkozë, Tiranë
16. **“Shkodra Beton” sh.p.k.**, Rr. “Durrësit”, ish serat, Tiranë
17. **“Best Construction Alb” sh.p.k.** (BestStar), Rr. “Kavajës”, Tirana Tower, Kati 6, Tiranë
18. **“Edil Al-It” sh.p.k.** (Tirana Beton), Rr. “Perlat Rexhepi”, Pall. 14-kat, Kati 2, Tiranë

KOMISIONI I KONKURRENCËS

VËREN SE:

Sekretariati i Autoritetit të Konkurrencës i ka kërkuar informacion ndërmarrjeve: “Alba-Beton” sh.p.k., “ANI” sh.p.k., “Alban-Tirana Co” sh.p.k., “Beton Ekspres”, “Delia Group” sh.p.k., “Eurovini” sh.p.k., “Eurobeton 2005” sh.p.k., “Euro Lines” sh.p.k., “Ferro Beton & Construction Co” sh.p.k., “Halili” sh.p.k., “Ital-Beton Construction”, “Kirchberger Albania” sh.p.k., “K.D.K” sh.p.k., “Qarri 02” sh.p.k., “Sina 98” sh.p.k., “Shkodra Beton” sh.p.k., “Best Construction Alb (BestStar)” sh.p.k., “Edil Al-It” sh.p.k. (Tirana Beton)”, me anë të shkresës nr. 487 datë 25.09.2007, “Njoftim për Vendimin e Komisionit të Konkurrencës për ndërprerjen e marrëveshjes dhe kërkesë për Informacion”.

Ndërmarrjet “Alban-Tirana Co” sh.p.k., “Beton Ekspres”, “Ferro Beton & Construction Co” sh.p.k., “Halili” sh.p.k., “Ital-Beton Construction”, “Kirchberger Albania” sh.p.k., “Qarri 02” sh.p.k., “Shkodra Beton” sh.p.k., “Best Construction Alb (BestStar)” sh.p.k. nuk i janë përgjigjur kërkesës për informacion sipas shkresës, nr 487 datë 25.09.2007, “Njoftim për Vendimin e Komisionit të Konkurrencës për ndërprerjen e marrëveshjes dhe kërkesë për Informacion” bashkangjitur formularin, në bazë të nenit 61 të Kodit të Procedurave Administrative.

Ky veprim përbën shkelje të lehtë në bazë të nenit 73, pika 1, germa a) të ligjit nr. 9121 “Për Mbrojtjen e Konkurrencës”.

PËR KËTO ARSYE:

Komisioni i Konkurrencës, bazuar në nenin 24, germa d, nenin 73, pika 1, germa a, dhe nenin 80 të Ligjit Nr. 9121, datë 28.07.2003, “Për Mbrojtjen e Konkurrencës”, me propozim të Sekretariatit,

VENDOSI:

1. Marrjen e masës së gjobës për shkelje të lehtë ndaj ndërmarrjeve të mëposhtme me 0.1 % të xhiros vjetore të vitit 2006.

Ndërmarrja	Masa e Gjobës
“ALBAN - TIRANA CO”	447915
BEST CONSTRICTION ALB	235367
BETON EKSPRES	178534
FERRO BETON & CONST.	436959
HALILI	172519
ITAL-BETON CONST.	201086
KIRCHBERGER - ALBANIA	508279
QARRI - 02	169652
SHKODRA BETON	396974

2. Ngarkohet Policia Tatimore për vjeljen e këtyre gjobave në vleftat e përcaktuara në pikën 1 të këtij Vendimi.
3. Ngarkohet Sekretariati për njoftimin e palëve.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

U shpall në Tiranë, sot më 18.12.2007

KOMISIONI I KONKURENCËS

Lush Përpali

Servete Gruda

Koço Broka

()

Zv/Kryetar

()

Anëtar

()

Anëtar

Lindita Milo (Lati)

K R Y E T A R E



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
AUTORITETI I KONKURRENCËS
KOMISIONI I KONKURRENCËS

V E N D I M

Nr.67, datë 24 /12 /2007

Për Vendosje sanksioni individual ndaj Z. Kajo Hallka

Komisioni i Konkurrencës me pjesëmarrjen e:

- Znj. Lindita Milo (Lati) Kryetar
- Zt. Lush Përpali zv/kryetar
- Znj. Servete Gruda Anëtar
- Zt. Koço Broka Anëtar

Në mbledhjen e tij të datës 24 /12 /2007, shqyrtoi çështjen me:

Objekt: Vendosje gjobe individuale ndaj Z. Kajo Hallka

Baza ligjore: • Ligji nr 9121, datë 28.07.2003 “Për Mbrojtjen e Konkurrencës”,
 neni 4, pika 1, neni 24, germa d, neni 78, pika 1 dhe neni 80
 • Kodi i Procedurave Administrative

Komisioni i Konkurrencës pas shqyrtimit të: • Raportit të Grupit të Punës,
 • Pretendimeve të palëve

VËREN SE:

Ndërmarrjet prodhuese të bukës, anëtare të shoqatës së prodhuesve të bukës “Apollonia” Fier, me kryetar Z. Kajo Hallka më datë 08.08.2007, kanë bërë një marrëveshje që bie në kundërshtim me nenin 4, pika 1, germa a), të Ligjit nr. 9121, datë 28.07.2003 “Për Mbrojtjen e Konkurrencës”, sepse fikson dhe rrit çmimet e shitjes së llojeve të ndryshme të bukës.

Gjatë procedurave hetimore, gjatë seancës dëgjimore dhe deklaratave të vetë Z. Kajo Hallka është konstatuar se ai ka qenë nxitësi dhe organizatori kryesor i kësaj marrëveshje. Z. Hallka gjatë kësaj periudhe është shfaqur në median e shkruar dhe vizive duke deklaruar lidhjen e kësaj marrëveshje e cila bie në kundërshtim me nenin 4, pika 1 të Ligjit nr. 9121, datë 28.07.2003 “Për Mbrojtjen e Konkurrencës”.

Në këtë mënyrë z. Hallka me dashje ka kryer veprimet e sanksionuara në nenin 74 pika 1.

PËR KËTO ARSYE:

Komisioni i Konkurrencës, bazuar në nenin 4, pika 1, nenin 24, germa d, nenin 78, pika 1 dhe nenin 80 të Ligjit Nr. 9121, datë 28.07.2003, “Për Mbrojtjen e Konkurrencës”,

VENDOSI:

1. Marrjen e masës së gjobës individuale ndaj Z. Kajo Hallka në masën 30.000 lek.
2. Ngarkohet Policia Tatimore për vjeljen e kësaj gjobe në vleftën e përcaktuara në pikën
3. Ngarkohet Sekretariati për njoftimin e palëve.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

U shpall në Tiranë, sot më 24.12.2007

KOMISIONI I KONKURRENCËS

Lush Përpali

Servete Gruda

Koço Broka

()
Zv/Kryetar

()
Anëtar

()
Anëtar

Lindita Milo (Lati)

K R Y E T A R E



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
AUTORITETI I KONKURRENCËS
KOMISIONI I KONKURRENCËS

V E N D I M

Nr.68, datë 24/12/2007

Për miratimin e Udhëzuesit

“Mbi Vlerësimin e Pasojave të Legjislacionit mbi Konkurrencën“

Komisioni i Konkurrencës me pjesëmarrjen e:

- Znj. Lindita Milo (Lati) Kryetar
- Zt. Lush Përpali zv/kryetar
- Znj. Servete Gruda Anëtar
- Zt. Koço Broka Anëtar

Në mbledhjen e tij të datës 24/12/2007, shqyrtoi çështjen me:

Objekt: Miratimi i Udhëzuesit “Mbi Vlerësimin e Pasojave të Legjislacionit mbi Konkurrencën“.

Baza ligjore: Ligji nr 9121, datë 28.07.2003 “Për Mbrojtjen e Konkurrencës”, neni 24, germa d, si dhe nenet 69 e 70.

KOMISIONI I KONKURRENCËS

VËREN SE:

Ligji nr 9121, datë 28.07.2003 “Për Mbrojtjen e Konkurrencës”, neni 69 vendos detyrimin ligjor për organet e administratës qendrore dhe vendore të kërkojnë vlerësimin e Autoritetit për çdo projekt akt normativ që, në mënyrë të veçantë, ka të bëjë me:

- a) kufizimet sasiore për hyrjen në treg dhe tregtimin;
- b) vendosjen e të drejtave ekskluzive ose të të drejtave të veçanta, në zona të caktuara, për ndërmarrje ose për produkte të caktuara;
- c) imponimin e praktikave të njëjta në çmime dhe kushtet e shitjes.

Gjithashtu në bazë të nenit 70 të ligjit nr 9121, datë 28.07.2003 “Për Mbrojtjen e Konkurrencës”, Autoritetet e administratës qendrore dhe vendore, entet dhe institucionet

e tjera rregullatorë, gjatë kryerjes së detyrave për rregullimin e veprimtarisë ekonomike në territorin e Republikës së Shqipërisë, janë të detyruara të zbatojnë dispozitat e këtij ligji dhe të sigurojnë një konkurrencë të ndershme dhe efektive.

Ndërsa Autoriteti i Konkurrencës për arsye të interesit të përgjithshëm, vlerëson, në veçanti, barrierat rregulluese të konkurrencës, të përfshira në rregullimin ekonomik dhe administrativ. Në këto raste Autoriteti bën rekomandimet përkatëse.

Vlerësimi i projekt-akteve ligjore për pasojat mbi konkurrencën është një kusht i domosdoshëm për të siguruar mbrojtjen e konkurrencës së lirë dhe efektive në treg.

PËR KËTO ARSYE:

Komisioni i Konkurrencës, bazuar në nenin 24, germa d, si dhe nenet 69 e 70 të Ligjit Nr. 9121, datë 28.07.2003, “Për Mbrojtjen e Konkurrencës”, me propozim të Sekretariatit,

VENDOSI:

1. Miratime Udhëzuesit “Mbi Vlerësimin e Pasojave të Legjislacionit mbi Konkurrencën”, sipas formës bashkëlidhur këtij vendimi së bashku me anekset përkatëse.
2. Ky udhëzues është i detyrueshëm për Autoritetin e Konkurrencës.
3. Ky udhëzues rekomandohet të zbatohet nga organet e administratës qendrore dhe vendore, në zbatim të detyrimit të përcaktuar në nenin 69 të Ligjit Nr. 9121 datë 28.07.2003 “Për Mbrojtjen e Konkurrencës”.
4. Ngarkohet Sekretariatit për dërgimin e këtij Udhëzuesi, pranë organeve të administratës qendrore dhe vendore, enteve dhe institucioneve të tjera rregullatorë.
5. Ky vendim hyn në fuqi menjëherë

U shpall në Tiranë, sot më 24.12.2007

KOMISIONI I KONKURRENCËS

Lush Përpali

Servete Gruda

Koço Broka

(_____)

(_____)

(_____)

Zv/Kryetar

Anëtar

Anëtar

Lindita Milo (Lati)

K R Y E T A R E



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
AUTORITETI I KONKURENCËS
KOMISIONI I KONKURENCËS

UDHËZUES

“PËR VLERËSIMIN E PASOJAVE TË LEGJISLACIONIT
MBI KONKURENCËN”

Mbështetur në nenin 24, shkronja d, si dhe nenet 69 dhe 70 të ligjit nr. 9121, datë 28.07.2003 “Për mbrojtjen e konkurrencës”, për vlerësimin e legjislacionit nga këndvështrimi i konkurrencës, Autoriteti i Konkurrencës

UDHËZON

I. Qëllimi

Qëllimi i këtij udhëzimi është përmirësimi i procesit të vlerësimit të projekt-akteve normative që prekin fushën e konkurrencës nëpërmjet analizimit të pasojave që mund të kenë këto akte mbi konkurrencën në treg si dhe përcaktimin i kritereve dhe standardeve që duhet të merren parasysh nga institucionet përkatëse, qendrore apo vendore, gjatë procesit të vlerësimit, për shmangien e pasojave kufizuese;

II. Domosdoshmëria e rregullimit dhe alternativat përpara hartuesit të akteve normative

2.1 Parime të përgjithshme të ndërhyrjes të shtetit

Ndërhyrja e shtetit në treg i nënshtrohet parimeve të përgjithshme kushtetuese. Megjithëse ky Udhëzim përqendrohet në vlerësimin e pasojave të legjislacionit mbi konkurrencën, disa nga kërkesat e një ekonomie tregu ku vepron në mënyrë efikase konkurrenca efektive mund të plotësohen nëse ndiqen këto parime të përgjithshme:

1. *Parimi i ligjshmërisë.* Një masë e marrë që prek aktivitetin ekonomik të ndërmarrjeve mund të merret vetëm me ligj;
2. *Parimi i interesit publik.* Shteti mund të ndërhyjë në treg vetëm me qëllim ndjekjen ose përmbushjen e një interesi publik;
3. *Parimi i proporcionalitetit.* Sipas nën parimit të përshtatshmërisë, masa e marrë duhet të jetë e tillë që të mund të përmbushë qëllimin e vënë. Sipas nën parimit të domosdoshmërisë, masa e propozuar duhet të jetë e domosdoshme për përmbushjen e interesit publik. Dhe sipas nën parimit të përpjesëtueshmërisë, kufizimi i veprimtarisë ekonomike dhe kufizimi

i parimit të ekonomisë së tregut duhet të jetë në përpjesëtim me objektivin e ndjekur.

Hartuesit e politikave dhe institucionet propozuese duhet të përcaktojnë qëllimin dhe objektivat që duhet të arrihen me aktin e propozuar. Pyetja kryesore që duhet të shtrohet është se përse është e nevojshme ndërhyrja e shtetit. Në përgjithësi, shteti ndërhyr me anë të një legjislacioni për të rregulluar një sektor ekonomik apo për të arritur objektiva të tjera sociale. Rregullimi ekonomik ka për qëllim eliminimin e dështimit të tregut, i cili mund të marrë formën e fuqisë së tregut deri në monopol natyror, eksternaliteteve (për shembull ndotja e ambientit); tregu mund të dështojë në ofrimin e disa lloj produkteve ose shërbimeve që janë në interes të të gjithëve (*public goods*); ose mund të dështojë në dhënien e informacioneve të domosdoshme për funksionimin e drejtë të një tregu. Nga ana tjetër, legjislacioni me objektiv social ka për qëllim ndër të tjera rritjen e sigurisë në vendin e punës, ose shpërndarjen sa më të drejtë të të ardhurave, rritjen e sigurisë së mallrave të konsumit, qofshin këto medikamente apo ushqime. Në lidhje me këtë të fundit, rregullat për informimin e konsumatorëve bëjnë të mundur ndërgjegjësimin e tyre në procesin e zgjedhjes së produkteve që konsumojnë.

2.2 Përcaktimi i qëllimit të legjislacionit

Një akt normativ hartohet dhe adoptohet me një qëllim të caktuar ekonomik, social apo organizativ. Shpjegimi i qëllimit të ligjit ndihmon qartësimin e objektivave që duhet të ndiqen. Për të arritur qëllimin dhe objektivat e përcaktuara, akti normativ parashikon masa ose instrumente të caktuara. Disa nga këto instrumente ose masa që parashikohen të merren mund të kenë një ndikim mbi konkurrencën dhe ta kufizojnë atë.

Për këtë qëllim, hartuesit e akteve normative duhet të shtrojnë 3 (tre) pyetje:

1. *së pari*, cili është qëllimi i përgjithshëm i hartimit të aktit normativ, dhe si rrjedhim i ndërhyrjes së shtetit;
2. *së dyti*, cilat janë masat dhe instrumentet që mendohet të përdoren për të arritur qëllimin ose objektivat e vëna;
3. *së treti*, cili është qëllimi i përdorimit të masës të përfshirë në dispozitën e identifikuar në analizën paraprake, masë e cila mund të kufizojë konkurrencën.

Kjo analizë mundëson autoritetin propozues të vlerësojë domosdoshmërinë e masave të identifikuara në pikën tre. Duhet pasur parasysh që në disa raste, problemet e tregut mund të zgjidhen përmes alternativave jo-rregullatore. Hartuesit e projekt-akteve duhet të marrin në konsideratë mundësinë e mos ndërhyrjes në treg, domethënë që të hiqet dorë nga hartimi i një projekt-ligji nëse avantazhet nuk janë qartësisht të identifikueshme. Nga ana tjetër duhen marrë parasysh mundësi të tjera ndërhyrje, si për shembull me anë të fushatave informuese dhe edukuese, dhe duke lejuar vetë-rregullimin ose duke mundësuar bashkë-rregullimi.

2.3 Identifikimi i alternativave dhe vlerësimi i pasojave mbi konkurrencën

Kur ekzistojnë dy ose më shumë mënyra për të arritur objektivin e legjislacionit, ligjbërësi duhet të vlerësojë pasojat negative ose pozitive mbi konkurrencën dhe të zgjedhë alternativën që nuk kufizon ose kufizon më pak konkurrencën ose atë që e nxit më shumë.

Kjo etapë presupozon identifikimin e alternativave në dispozicion. Për këtë, këshillimi me përfaqësuesit e industrisë mund të jetë shumë i vlefshëm.

Nëse identifikohet një masë ose instrument, i përfshirë në një dispozitë të projekt-aktit, i cili mund të kufizojë konkurrencën, hartuesit duhet të marrin analizojnë nëse ekzistojnë apo jo alternativa të tjera për që kufizojnë më pak konkurrencën por gjithashtu duke mos cenuar arritjen e objektivave dhe qëllimit të përgjithshëm. Institucionet hartuese të projekt-akteve

duhet të bëjnë një vlerësim paraprak të pasojave të çdo masë alternative mbi konkurrencën në tregjet e prekura. Në këtë mënyrë, i jepet mundësia hartuesve të politikave apo institucioneve propozuese që të paraprijnë problemeve që mund të dalin si dhe të reduktojnë mundësitë e pasojave të paparashikuara në treg. Së fundi, duke vlerësuar paraprakisht pasojat kufizuese mbi konkurrencën në treg, hartuesit do të mund të krahasojnë masat apo instrumentet alternative dhe të identifikojnë atë që kufizon më pas konkurrencën.

Në këtë etapë, është e rëndësishme që hartuesit të bëjnë një listë me subjektet e prekura në mënyrë të drejtpërdrejtë ose jo nga masa ose instrumenti i parashikuar. Në shumë raste, ky identifikim është i qarte por në disa raste, nevojitet të përdoret procesi konsultues për të identifikuar se kush është prekur nga propozimet e tyre.

III. Etapat e vlerësimit legjislativ

Vlerësimi Legjislativ ndiqet në dy etapa të përshkallëzuar të cilat janë: Etapa e Vlerësimit Paraprak dhe Etapa e Vlerësimit të Detajuar:

a) Etapa e Vlerësimit Paraprak

Kjo etapë identifikon propozimet që mund të kenë rrezikun më të madh në lidhje me pasojën mbi konkurrencën.

Në këtë etapë, vlerësimi kryhet duke u bazuar në pyetësin, sipas Aneksit 1, bashkëlidhur këtij udhëzimi, me qëllim identifikimin e dispozitave që rrezikojnë të kufizojnë konkurrencën në treg.

Nga përgjigjet e marra, do të vlerësohet nëse projekt-akti normativ rrezikon të ketë pasoja mbi konkurrencën. Nëse nga analiza e dispozitave rezulton qoftë dhe një përgjigje pozitive ndaj pyetjeve të pyetësit, ky projekt-akt i nënshtrohet vlerësimit të detajuar. Hartuesit e projekt-akteve normative duhet ta shohin atë me një sy kritik, domethënë të nxiten nga ky pyetësor dhe të identifikojnë çdo dispozite të ngjashme me shembujt e dhënë në pyetësor dhe që ata gjykojnë që mund të ketë pasoja negative të ngjashme mbi konkurrencën.

Pas identifikimit të dispozitës që mund të kufizojë konkurrencën institucioni hartues i projekt-aktit normativ, përgatit një informacion të shkurtër në lidhje me vlerësimin i cili përmban:

- a) një shpjegim të masave të marra në dispozitën e identifikuar dhe të qëllimit të hartimit të këtij akti normativ (shih më poshtë pikën III shkronja b të këtij udhëzimi);
- b) një shpjegim nëse kjo masë ka apo jo ndonjë pasojë të dëmshme për konkurrencën;
- c) një shpjegim të përgjigjeve pozitive të pyetjeve të parashtruara në Aneksin 1 të këtij udhëzimi, duke shpjeguar në mënyrë sa më konkrete përgjigjet e dhëna.

Pas përgatitjes së informacionit, institucioni nismëtar, njofton zyrtarisht Autoritetin e Konkurrencës. Më pas, të dy institucionet do të ndërmarrin mbledhjen e një informacioni shtesë dhe kryerjen e një vlerësimi të detajuar të konkurrencës në lidhje me aktin e propozuar. Ky vlerësim i detajuar do të jetë në proporcionalitet me shkallën e pasojave mbi konkurrencën

b) Etapa e Vlerësimit të detajuar

Me anë të këtij vlerësimi bëhet identifikimi në mënyrë më të hollësishme i natyrës dhe shkallës së pasojave që mund të rrjedhin nga zbatimi i projekt-aktit të propozuar, në proporcionalitet me shkallën e pasojave mbi konkurrencën.

IV. Metodologjia e përgjithshme për vlerësimin e pasojave të legjislacionit mbi konkurrencën

Ky vlerësim bëhet duke marrë parasysh analizën që realizohet nëpërmjet Pyetësorit për Hartuesit e akteve normative sipas Aneksit 1 të bashkëlidhur si dhe pikat e mëposhtme:

1. Pasojat e legjislacionit mbi numrin e ofruesve në treg

Në këtë raste duhen marrë në konsideratë dhe analizuar:

1.1 Kufizimi i drejtpërdrejtë i numrit të ofruesve

Legjislacioni mund të kufizojë në mënyrë të drejtpërdrejtë, numrin e ofruesve në treg me parashikimin e të drejtave ekskluzive ose të veçanta, licencave ose autorizimeve për të ushtruar një aktivitet ekonomik. Legjislacioni ndikon në numrin e ofruesve në treg nëse disa ndërmarrje ndalohen të tregtojnë një produkt ose shërbim të caktuar. Gjithashtu, legjislacioni kufizon numrin e ofruesve nëse vë pengesa në hyrjen e ndërmarrjeve të reja në treg. Duhet theksuar që hyrja, ose kërcënimi për të hyre në treg, është një presion i rëndësishëm konkurrues mbi kompanitë ekzistuese në treg. Politikrat që në mënyrë të drejtpërdrejtë pengojnë hyrjen krijojnë mundësinë që të pengojnë presionin konkurrues ndaj kompanive ekzistuese.

1.2 Kufizimi tërthortë i numrit të ofruesve

Numri i ofruesve në treg kufizohet në mënyrë jo të drejtpërdrejtë, kur legjislacioni vendos kushte për hyrjen ose kërkesa të veçanta gjatë ushtrimit të aktivitetit ekonomik.

Në këto kushte vlerësimi i pasojave mbi konkurrencën duhet të përqendrohet duke identifikuar rastet e mëposhtme:

- Legjislacioni i propozuar rrit në mënyrë të ndjeshme koston e furnizuesve të rinj në krahasim me furnizuesit ekzistues;
- Legjislacioni i propozuar rrit në mënyrë të ndjeshme koston e disa furnizuesve ekzistues në krahasim me furnizues të tjerë ekzistues;
- Legjislacioni i propozuar rrit në mënyrë të ndjeshme kostot e hyrjes, apo daljes, në tregun e prekur.

2. Pasojat e legjislacionit mbi kërkuesit (konsumatorët)

Kufizimi i Konkurrencës ndodh edhe kur një masë e marrë kufizon mundësinë e konsumatorëve për të zgjedhur ose për të ndërruar/zëvendësuar një produkt me një tjetër. Kjo ndodh në rastin kur çdo masë që ndikon në zgjedhjen e konsumatorëve ul dhe nivelin e zëvendësueshmërisë ndërmjet produkteve të ndryshme.

Në këtë vlerësim merret parasysh:

2.1 Kufizimi i zgjedhjes së konsumatorëve

Nëse një projekt-akt normativ kufizon mundësinë e konsumatorëve të furnizohen jashtë një zone të caktuar gjeografike ose i detyron ata të furnizohen tek një furnizues të caktuar, mundësia e kufizuar në zgjedhje, ul konkurrencën duke sjellë në këtë mënyrë dhe uljen e cilësisë së shërbimeve për konsumatorët.

2.2 Rritja e kostos së zëvendësimit të ofruesve

Kostoja e zëvendësimit të ofruesve mund të rritet nëse ligji parashikon afate të gjata për denoncimin e kontratave, ose mundësi të kufizuar për ndërrimin e furnizuesve.

3. Pasojat e legjislacionit mbi parametrat e konkurrencës (çmimi, sasia, teknologjia, etj)

Legjislacioni mund të ndërhyjë në mënyrë të drejtpërdrejtë ose të tërthortë mbi parametrat kryesorë të konkurrencës siç janë:

3.1 Kontrolli i çmimeve

Projekt-aktet normative mund të parashikojnë kontrollin e çmimeve me anë të një fiksimit paraprak të çmimeve nga një autoritet kompetent ose me anë të miratimit të çmimeve të propozuara nga ndërmarrjet ose një shoqatë ndërmarrjesh. Rekomandimet e çmimeve mund të kenë të njëjtën pasojë nëse respektohen nga shumica e ndërmarrjeve në treg. Fiksimi i çmimeve përbën një nga kufizimet më të dëmshme për konkurrencën.

3.2 Kufizimi i sasisë së prodhuar ose ofruar

Kufizimi i sasisë së prodhuar ose ofruar në treg ka për pasojë rritjen e çmimeve dhe uljen e cilësisë. Ky kufizim mund të bëhet në mënyrë të drejtpërdrejtë: çdo ndërmarrje duhet të prodhojë një sasi të caktuar; ose në mënyrë të tërthortë: legjislacioni rrit koston e prodhimit gjë që rezulton dhe në uljen e sasisë së prodhuar.

3.3 Kufizimi i teknologjisë së përdorur

Përdorimi i teknologjisë mund të kufizohet nga:

- adoptimi i një standardi teknik ose teknologjik;
- kufizimi i përdorimit të një procesi ekonomik;
- kufizimi i hapësirës për novacione;
- kufizimet mbi procesin e prodhimit apo mbi mënyrat e furnizimit të produktit.

3.4 Pasoja të legjislacionit mbi parametra të tjerë

- Kufizimi i reklamës;
- Nxitja e bashkëpunimit ndërmjet ndërmarrjeve;
- Reduktimi i cilësisë dhe i shumëllojshmërisë.

4. Pasoja të rregullimit mbi barazinë e konkurruesve

Miratimi i një legjislacioni që kushtëzon veprimtarinë e operatorëve në treg me marrjen e një vendimi paraprak rrezikon të diskriminojë operatorët duke përkrahur në këtë mënyrë disa prej tyre në treg. Në rregullimin e pasojave mbi barazinë e konsumatorëve të merret parasysh:

4.1 Parimi i barazisë në ligj

Aktet normative duhet të trajtojnë në mënyrë të barabartë ndërmarrjet në treg ndërsa trajtimi i ndryshëm duhet të bazohet në kritere objektive.

4.2 Parimi i barazisë në zbatimin e ligjit

Për të evituar shtrembërim të konkurrencës, ligjberësi duhet të parashikojë instrumente dhe mjete të mjaftueshme për zbatimin e ligjit, me qëllim zbatimin e njëjtë për të gjithë pjesëmarrësit në treg dhe garantimin e kushteve bazë të njëjta.

IV. Pas ndjekjes së hapave të sipërcituara i rekomandohet institucionit nismëtar të projekt –aktit që të bëjë një analizë më të thellë të dispozitave përkatëse si dhe të marrë masat për ndryshimin e dispozitave që nga vlerësimi i detajuar rezultojnë që kufizojnë konkurrencën e lirë dhe efektive në treg.

Një shembull Vlerësimi Legjislativ jepet në aneksin 2, bashkangjitur këtij udhëzimi.

ANEKS 1**PYETËSOR PËR HARTUESIT E AKTEVE NORMATIVE**

Pyetje mbi pasojat e legjislacionit mbi konkurrencën	Po	Jo	Nuk e di
A ka lidhje/ a ka të bëjë legjislacioni në mënyrë të drejtpërdrejtë me produkte ose shërbime të caktuara? Në veçanti, ka të bëjë legjislacioni me rregullat e prodhimit ose tregimit, të shitjes ose të blerjes të një produkti?			
A ka pasoja të drejtë për drejta ose të tërthorta legjislacioni mbi ndërmarrjet që veprojnë në sektorin ekonomik ose sektorët ekonomikë të përfshirë në rregullim?			
Parashikon legjislacioni përjashtim të sektorit ekonomik ose të veprimtarisë së disa ndërmarrjeve nga fusha e zbatimit të ligjit për mbrojtjen e konkurrencës?			

Pasojat direkte mbi strukturën = numrin e ndërmarrjeve

A ndikon legjislacioni në numrin ose madhësinë e ndërmarrjeve që veprojnë në treg?			
A parashikon ligji licencë ose forma të tjera autorizimi për ushtrimin e aktivitetit ekonomik në treg?			
A parashikon ligji të drejta ekskluzive ose të veçanta për një ose më shumë ndërmarrje në treg?			
A parashikon ligji një numër limit të ndërmarrjeve aktive në treg?			

Pasojat mbi koston e prodhimit ose shpërndarjes

A rrit legjislacioni koston për ndërmarrjet aktive në një ose disa tregje?			
A preken disa ndërmarrje ekzistuese më shumë se të tjerat nga kostoja e rregullimit ?			
A rrit ligji koston e fillimit të aktivitetit për ndërmarrjet që duan të hyjnë në treg?			
A rrit ligji koston operacionale për ndërmarrjet që mund të hyjnë në treg pa rritur koston e ndërmarrjeve ekzistuese ?			

Pasojat mbi sjelljen e ndërmarrjeve

Pyetje mbi pasojat e legjislacionit mbi konkurrencën	Po	Jo	Nuk e di
A kufizon legjislacioni mundësinë e ndërmarrjeve për të zgjedhur çmimin e produkteve të tyre ?			
A kufizon legjislacioni mundësinë e ndërmarrjeve për të zgjedhur cilësinë e produkteve të tyre ?			
A kufizon legjislacioni mundësinë e ndërmarrjeve për të zgjedhur gamën e produkteve të tyre ?			
A kufizon legjislacioni mundësinë e ndërmarrjeve për të zgjedhur teknologjinë për prodhimin ose shpërndarjen e produkteve të tyre ?			
A kufizon legjislacioni mundësinë e ndërmarrjeve për të bërë reklamë për produktet ose shërbimet e tyre?			

Pasojat mbi kërkesën

A kufizon ligji mundësinë e konsumatorëve ose klientëve të një produkti për të zgjedhur ndërmjet ndërmarrjeve që ofrojnë produkte ose shërbime të ngjashme?			
---	--	--	--

Pasojat mbi organizimin dhe fushën e veprimit

A kufizon legjislacioni lirinë e organizimit e brendshëm të veprimtarisë së ndërmarrjeve aktive në treg?			
A kufizon legjislacioni lirinë e ndërmarrje për të qenë aktive në një nivel tjetër të tregut ose në një treg tjetër (prodhim-shpërndarje)?			
A nxit legjislacioni kontaktet ndërmjet ndërmarrjeve aktive në të njëjtin treg ose në nivele të ndryshme të prodhimit ose shpërndarjet së këtij produkti?			

ANEKS 2**SHEMBULL VLERËSIMI LEGJISLATIV**

Vlerësimi i pasojave të mundshme mbi konkurrencën të neneve 99 dhe 100 të ligjit Nr. 9267, datë 29.7.2004, “Për veprimtarinë e sigurimit, të risigurimit dhe ndërmjetësimit në sigurime dhe risigurimeve”

I. Dispozita në shqyrtim

Ky vlerësim legjislativ ka për qëllim vlerësimin e pasojave të mundshme mbi konkurrencën të dispozitave që parashikojnë mënyrën e llogaritjes dhe miratimin e primeve të pastra në sektorin e sigurimeve dhe risigurimeve.

Sipas nenit 99 të ligjit 9267 mbi “Primet e sigurimit ose të risigurimit” (këtej e tutje “Ligji për sigurimet”), primi i sigurimit ose i risigurimit përbëhet nga:

- a. pjesa e llogaritur për mbulimin e rrezikut të marrë në sigurim i quajtur primi i pastër;
- b. pjesa e llogaritur për mbulimin e shpenzimeve administrative;
- c. elementet e kursimit për klasa të caktuara të sigurimit të jetës;
- ç. pjesa e llogaritur për fitimin e shoqërisë, duke përfshirë fitimin nga investimi pa risk dhe investimi në sigurime me risk.

Neni 100 parashikon miratimin i primeve:

1. Primi i pastër për mbulimin e rrezikut të marre në sigurimin e detyrueshëm miratohet nga Ministri i Financave.
2. Primet e sigurimit vullnetar përcaktohen nga vetë shoqëria e sigurimit.
3. Autoriteti, në funksion të mbikëqyrjes së veprimtarisë së shoqërisë së sigurimit, kërkon bazat teknike të përdorura për llogaritjen e tarifave dhe primeve për të gjitha produktet e sigurimit vullnetar.
4. Autoriteti, për shoqëritë që ushtrojnë veprimtarinë e sigurimit të jetës, ka të drejtë të rekomandojë bazën e të dhënave statistikore që përdoren në llogaritjen e primit.
5. Shoqëria e sigurimit dhe ndërmjetësit në sigurime janë të detyruar të zbatojnë primet e sigurimit të detyrueshëm.

II. Qëllimi i legjislacionit dhe i dispozitës së veçantë

Ligji për sigurimet ka si objekt vendosjen e parimeve dhe e rregullave të përgjithshme për veprimtarinë e sigurimit dhe të risigurimit, të ndërmjetësimit në sigurime dhe risigurime dhe mbikëqyrjen nga shteti të subjekteve që marrin përsipër të ushtrojnë veprimtarinë e parashikuara në këtë ligj (neni 1). Me “sigurim” nënkuptohet transferimi i një rreziku të mundshëm, të një humbjeje financiare ose të një dëmi material nga i siguruari të siguresi, sipas një kontrate sigurimi (neni 3 pika 1 e Ligjit për sigurimet).

Sigurimi ndahet në “sigurim të detyruar”, i cili nënkupton sigurimin, për të cilin ekziston

një detyrim ligjor; dhe në “sigurimin vullnetar”, i cili nënkupton sigurimin, për të cilin nuk ekziston një detyrim ligjor (neni 3 pika 2 dhe 3 i Ligjit për sigurimin).

Aktiviteti i sigurimit ka dy karakteristika të përgjithshme: nga njëra anë shoqëritë e sigurimit kryen një tërësi operacionesh të njëjtës natyrë me qëllim shpërndarjen e rrezikut tek të gjithë të siguruarit; nga ana tjetër, i siguruari nënshkruan një kontratë e cila i garanton mbulimin e një rreziku të mundshëm përkundrejt pagesës së një primi, i cili përfaqëson dhe “çmimin” e paguar për shërbimin e ofruar.

Meqë shoqëritë e sigurimit duhet të jenë afta të “shpërndajnë” rrezikun dhe të përmbushin detyrimet kontraktore ndaj të siguarve, ligji për sigurimin i kushton një vëmendje të veçantë “menaxhim i rrezikut”, i cili nënkupton tërësinë e metodave dhe të rregullave që përdoren nga shoqëria e sigurimit ose e risigurimit për përcaktimin, vlerësimin dhe analizimin e të gjitha rreziqeve të mundshme, me qëllim shmangien e humbjeve financiare (neni 3 pika 37).

Llogaritja e primit të parashikuar në nenin 99 dhe miratimi i primeve të parashikuara në nenin 100 të Ligjit për sigurimet kanë për qëllim menaxhimin e rrezikut. Kjo shihet nga vendosja e këtyre dy dispozitave në kreun e menaxhimit të rrezikut dhe veçanërisht në seksionin që i përket kapitalit të shoqërisë së sigurimit. Vjelja e primit nga të siguarit përbën dhe të ardhurën kryesore të shoqërive të sigurimit, gjë që tregon dhe rolin e kontrollit të llogaritjes së primit dhe kontrollit të nivelit të primit nga Ministria e Financave dhe Autoritetit mbikëqyrës së këtij sektori.

III. Alternativat ekzistuese për arritjen e qëllimit të dëshiruar

Kreu VI i ligjit për sigurimet jep një sërë rregullash të cilat kanë për qëllim të sigurojnë që shoqëritë e sigurimit të mund të shlyejnë detyrimet ndaj të siguarve si dhe një sërë rregullash kontabël që kanë si qëllim sigurimin e kontrollit të vazhdueshëm të gjendjes financiare të shoqërive të sigurimit. Shoqëria e sigurimit, gjatë gjithë veprimtarisë së saj, duhet të zotërojë një kapital të mjaftueshëm, që përbën edhe aftësinë paguese të saj (neni 96 pika 1 e Ligjit për sigurimet).

1. Rezervat e sigurisë

Ligji për sigurimet parashikon krijimin dhe mbajtjen e rezervave të sigurisë, të cilat janë aktivet që shërbejnë për të mbuluar përgjegjësitë afatgjata të shoqërisë së sigurimit. Rezerva minimale përbëhet nga jo më pak se 15 për qind dhe nuk kalojnë 30 për qind të totalit të primeve të shkruara neto mesatare vjetore në dy vitet e fundit. Kjo rezerve krijohet për të garantuar aftësinë paguese dhe fondin e garancisë së shoqërisë së sigurimit (neni 93 pika 3 i Ligjit për sigurimet). Për këtë, shoqëria e sigurimit është e detyruar të krijojë dhe të mbajë çdo vit financiar me burimet e veta rezervën e sigurisë në nivelin jo më pak se 1/3 e fitimit të vitit ushtrimor, nëse fitimi nuk përdoret për mbulimin e humbjeve të trashëguara nga vitet e mëparshme (neni 93 pika 1 i Ligjit për sigurimet).

2. Provizionet teknike dhe matematike

Në bilancin e shoqërive të sigurimit duhet të figurojnë provizione teknike dhe matematike të mjaftueshme për sigurimin e pagesës totale të detyrimeve ndaj të siguarve (neni 101 i Ligjit për sigurimet).

Gjatë gjithë veprimtarisë së saj, shoqëria e sigurimit duhet të mbulojë këto provizione teknike dhe matematike me aktive ekuivalente. Aktivet në mbulim të provizioneve teknike dhe matematike duhet të korrespondojnë me përgjegjësitë financiare të kontraktuara. Investimi i aktiveve në mbulim të provizioneve teknike dhe matematike duhet të

respektojnë rregulla mbi ruajtjen e vlerës, përfitueshmërisë dhe likuiditetit të investimeve (neni 102 i Ligjit për sigurimet).

3. Fondi i garancisë

Shoqëritë e sigurimeve duhet të depozitojnë në një bankë një fond garancie, i cili duhet të jetë i barabartë me 1/3 e nivelit të kërkuar të aftësisë paguese ose i kapitalit të shoqërisë. Ligji parashikon kufij minimalë për çdo klasë sigurimi (neni 98 i Ligjit të sigurimit).

Nga kjo analizë e shkurtër e ligjit vihet re që ekzistojnë mekanizma të tjerë për mbulimin e rrezikut të aktivitetit të sigurimit dhe risigurimit si detyrimi për krijimin e rezervave të sigurisë (neni 93), rregullat për investimin e kapitalit (neni 95) ose detyrimi për mbajtjen e një fondi garancie (neni 98). Këto mekanizma kanë për qëllim vetëm menaxhimin e rrezikut të aktivitetit të sigurimit dhe risigurimit. Ato nga një anë bazohen në kritere objektive, nga ana tjetër nuk ndërhyjnë në çmimin final në treg as dhe në sasinë ose cilësinë e produkteve të sigurimit ose risigurimit.

IV. Vlerësimi i pasojave mbi konkurrencën

Në radhë të parë, duhet bërë dallimi ndërmjet rregullave ose metodologjisë për llogaritjen e primit dhe miratimit të primit ose një pjese të tij. Gjithashtu, duhet bërë dallimi ndërmjet sigurimit vullnetar dhe ai i detyruar.

1. Sigurimi i detyruar

Në bazë të nenit 100 pika 1 të Ligjit për sigurimet, Ministri i Financave miraton *primi i pastër* për mbulimin e rrezikut të marre në *sigurimin e detyrueshëm*. Primi i pastër quhet pjesa e primit e cila llogaritet të mbulojë rrezikun e marrë në sigurim (neni 99 shkronja a) i Ligjit për sigurimin).

Primi i pastër përbën dhe një nga kostot kryesore të primit final të sigurimit. Nëse ky element i kostos kontrollohet nga një autoritet mbikëqyrës, kjo do të thotë një pjesë e rëndësishme e kostos miratohet nga autoritetet publike. Miratimi nënkupton dhe mundësinë e refuzimit të një primi të propozuar nga një shoqëri sigurimi, dhe me këtë vendosjen e një primi më të ulët ose më të lartë. Miratimi i një primi të njëjtë për çdo ndërmarrje (primi të njëjtë në treg) eliminon konkurrencën. Autoriteti mbikëqyrës mund të miratojë dhe një nivel të ndryshëm të primit për çdo ndërmarrje, nivel primi ky që do i korrespondonte më shumë nivelit të rrezikut të marrë nga çdo ndërmarrje. Ndryshimi i propozimit të ndërmarrjeve si dhe fiksimi i një niveli më të ulët ose më të lartë do të prishte ekuilibrin në treg duke disavantazuar një nga ndërmarrjet nga shoqëritë e tjera. Gjithashtu, fiksimi i primit të pastër mund të përmbajë një gabim të nivelit të tij, i cili mund të rezultojë në inefficencë alokative dhe produktive.

Nëse miratimi i primit ka për qëllim sigurimin e mbulimin të rrezikut të përgjithshëm, duhet analizuar me autoritetet kompetente se në çfarë rastesh miratimi i primit të pastër i shërben qëllimit të menaxhimit të rrezikut. Gjithashtu, analiza e përbashkët me autoritetet mbikëqyrëse duhet të vlerësojë nëse mekanizmat e tjerë të përdorur të paraqitur në pjesën e tretë (III) janë të mjaftueshëm për menaxhimin e rrezikut. Miratimi i primit të pastër është i domosdoshëm nëse mekanizmat e tjerë janë të pamjaftueshëm. Së fundi, në qoftë se miratimi i primit të pastër bëhet me qëllim mbulimin dhe menaxhimin e rrezikut të sigurimit, duhet analizuar përse ky mekanizëm i zbatohet vetëm sigurimit të detyruar.

Nëse një masë e tillë është efikase dhe e nevojshme për menaxhimin e rrezikut të sigurimit, nuk ka pse të bëhet dallim ndërmjet sigurimit të detyruar dhe atij vullnetar.

Së fundi, pika 5 e nenit 100 parashikon që shoqëria e sigurimit dhe ndërmjetësit në sigurime janë të detyruar të zbatojnë primet e sigurimit të detyrueshëm. Kjo dispozitë është shumë e paqartë mbi pjesën e primit që duhet të miratohet nga autoriteti mbikëqyrës. Është e qartë që miratimi i totalitetit të primit nuk mund të ketë si qëllim menaxhimin e rrezikut të sigurimit, sepse një pjesë e mirë e primit nuk varet nga ky risk. Nga ana tjetër, meqë sigurimi është i detyruar me ligj, mund të jetë e domosdoshme që primet finale (ose çmimi final) të miratohet nga një organ kompetent për të mënjanuar shfrytëzimin dhe abuzimin e konsumatorëve (të siguruarve). Në këtë rast, autoriteti mund të fiksojë një prim maksimal të cilën shoqëritë e sigurimit nuk mund ta kalojnë. Konkurrenca me çmimet (primet) mbetet gjithmonë e mundshme.

2. Sigurimi vullnetar

Në bazë të nenit 100 pika 2 dhe 3, “primet e sigurimit vullnetar përcaktohen nga vetë shoqëria e sigurimit. Autoriteti, në funksion të mbikëqyrjes së veprimtarisë së shoqërisë së sigurimit, kërkon bazat teknike të përdorura për llogaritjen e tarifave dhe primeve për të gjitha produktet e sigurimit vullnetar.”

Siç shihet, parashikimi dhe monitorimi i mënyrës së llogaritjes së primit mund të përbëjë një mekanizëm efikas dhe të domosdoshëm për menaxhimin e rrezikut të sigurimit; nga ana tjetër kontrolli ose miratimi i rregullave për mënyrën e llogaritjes së primit të pastër nuk kufizon ndjeshëm konkurrencën. Në këtë rast parimi i konkurrencës është respektuar.

3. Sigurimi i jetës

Sipas pikës 4 të nenit 100, “autoriteti, për shoqëritë që ushtrojnë veprimtarinë e sigurimit të jetës, ka të drejtë të rekomandojë bazën e të dhënave statistikore që përdoren në llogaritjen e primit”. Në këtë rast autoriteti nuk kontrollon mënyrën e llogaritjes së primit të një shoqërie sigurimi individuale, por mund të rekomandojë një bazë statistikore për llogaritjen e primit. Një rekomandim i tillë është i justifikueshëm për arsye të menaxhimit më eficient të rrezikut.

Nga ana tjetër, ky rekomandim duhet të kufizohet në dhënien e të dhënave statistikore ose në dhënien e formulave të llogaritjes. Kontaktet ndërmjet shoqërive të sigurimit nga njëra anë, dhe autoriteti nga ana tjetër, mund të shërbejnë dhe për shkëmbimin e eksperiencës për llogaritjen e rrezikut. Shoqëritë e sigurimit në këtë rast të përcaktojnë nivelin e primit si dhe politikën e uljeve të çmimeve. Rekomandimet e autoritetit mbikëqyrës nuk duhet të lehtësojnë shkëmbimin e informacioneve ndërmjet shoqërive të sigurimit dhe as të japin informacione mbi sjelljen efektive të tyre në treg.

V. Peshimi i pasojave pozitive dhe negative

Miratimi ose caktimi i primit të pastër për sigurimin e detyruar ka pak mundësi të shërbejë për menaxhimin e rrezikut të sigurimit. Nga njëra anë mekanizmat e tjerë të parashikuar në ligj – rezervat e sigurisë, provizionet teknike dhe fondet e garancisë – mund të jenë të mjaftueshme për mbulimin e rrezikut të sigurimit nga shoqëritë e sigurimit. Kjo përforcohet dhe nga fakti që miratimi i primit të pastër nuk parashikohet për sigurimin vullnetar.

Miratimi ose caktimi i primit të pastër ka si pasojë fiksimin e një pjese të rëndësishme të çmimit final të tregut. Megjithëse autoriteti mbikëqyrës mund të miratojë nivele të ndryshme primesh për shoqëri të ndryshme, kjo masë rrezikon të çojë në nivelimi e primeve drejt një çmimi minimal, i cili mund të kufizojë konkurrencën në tregun e sigurimeve të detyrueshme. Pasojat e mundshme negative kalojnë në këtë rast të pasojat pozitive.

Përcaktimi i bazës së llogaritjes justifikohet nëse ajo shërben për llogaritjen dhe menaxhimin e rrezikut. Në sektorin e sigurimeve këto skema llogaritje dhe bazat e përbashkëta rrisin eficiencën ekonomike dhe ndihmojnë në mbulimin e rrezikut të sigurimit.

VI. Përfundimi i analizës dhe rekomandime

Rekomandohet që autoriteti mbikëqyrës të bëjë një analizë më të thellë për domosdoshmërinë e mekanizmit të miratimit të primit të pastër për sigurimin e detyruar. Nëse ky mekanizëm nuk përmirëson në mënyrë të dukshme menaxhimin e rrezikut të sigurimit, duhet parashikuar modifikimi i kësaj dispozite.



**REPUBLIKA E SHQIPËRISË
AUTORITETI I KONKURRENCËS
KOMISIONI I KONKURRENCËS**

V E N D I M

Nr.69, datë 24/12/2007

PËR MIRATIMIN E

“KODIT TË ETIKËS SË AUTORITETIT TË KONKURRENCËS”

Komisioni i Konkurrencës me pjesëmarrjen e:

- Znj. Lindita Milo (Lati) Kryetar
- Zt. Lush Përpali zv/kryetar
- Znj. Servete Gruda Anëtar
- Zt. Koço Broka Anëtar

Në mbledhjen e tij të datës 24.12.2007, në mbështetje të nenit 24 të Ligjit nr 9121, datë 28.07.2003 “Për Mbrojtjen e Konkurrencës”, me propozimin e Sekretarit të Përgjithshëm dhe duke marrë parasysh Ligjin Nr. 8549 ,datë 11.11.1999 “Statusi i Nëpunësit Civil”, Ligjin Nr 9131 ,datë 08.09.2003 “Për Rregullat e Etikës Administratën Publike”, Ligjin Nr. 9367, datë 07.04.2005 “ Për Parandalimin e konfliktit të interesit në ushtrimin e funksioneve publike”, Ligjin Nr. 9121, datë 28.07.2003 “Për Mbrojtjen e Konkurrencës”, Ligjin nr 8484, datë 12.05.1999 “Kodi i Procedurave Administrative”, si dhe eksperiencën e Autoriteteve të Konkurrencës të vendeve anëtare të BE-së:

VENDOSI:

1. Miratimin e “Kodit të Etikës së Autoritetit të Konkurrencës”, bashkëlidhur këtij vendimi.
2. Ngarkohet Shefi i Kabinetit dhe Sekretari i Përgjithshëm për të marrë masat e nevojshme për përfshirjen në aktet e emërimit dhe në kontratën e punës të klauzolave për njohjen dhe zbatimin e këtij Kodi.
3. Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

KOMISIONI I KONKURENCËS

Lush Përpali

Servete Gruda

Koço Broka

(_____)
Zv/Kryetar

(_____)
Anëtar

(_____)
Anëtar

Lindita Milo (Lati)

KRYETARE

Kodi i Etikës i Autoritetit të Konkurrencës

Në mbështetje të nenit 24 të Ligjit nr 9121, datë 28.07.2003 “Për Mbrojtjen e Konkurrencës”, duke marrë parasysh Ligjin Nr. 8549, datë 11.11.1999 “Statusi i Nëpunësit Civil”, Ligjin Nr 9131, datë 08.09.2003 “Për Rregullat e Etikës Administratën Publike”, Ligjin Nr. 9367, datë 07.04.2005 “Për Parandalimin e konfliktit të interesit në ushtrimin e funksioneve publike”, Ligjin Nr. 9121, datë 28.07.2003 “Për Mbrojtjen e Konkurrencës”, Ligjin nr 8484, datë 12.05.1999 “Kodi i Procedurave Administrative”, si dhe eksperiencën e Autoriteteve të Konkurrencës të vendeve anëtare të BE-së,

Komisioni i Konkurrencës miraton këtë Kod Etike si më poshtë

Neni 1

Qëllimi

Qëllimi i këtij Kodi është të përcaktojë standardet e përgjithshme në ushtrimin e veprimtarisë së Autoritetit të Konkurrencës, në përputhje me misionin e këtij institucioni të pavarur në ushtrimin e veprimtarisë së tij në funksion të zhvillimit dhe mbrojtjes së konkurrencës së lirë dhe efektive në treg.

Neni 2

Fusha e zbatimit

- 2.1. Ky Kod Etike zbatohet për të gjithë zyrtarët e Autoritetit të Konkurrencës.
- 2.2. Termi “zyrtar” në kuptim të këtij kodi përdoret për:
 - a) anëtarët e Komisionit të Konkurrencës,
 - b) nëpunësit e Kabinetit
 - c) nëpunësit që gëzojnë statusin e nëpunësit civil,
 - d) nëpunësit ose bashkëpunëtorët me kontratë të përkohshme.

Neni 3

Dispozita të përgjithshme

- 3.1. Gjatë ushtrimit të detyrës së tij, zyrtari punon për të arritur standardet më të larta të etikës profesionale e personale në përputhje me legjislacionin e detyrueshëm për zbatim.
- 3.2. Dispozitat e këtij Kodi mbështeten dhe plotësojnë parimet e përgjithshme si i drejtësisë, barazisë, ligjshmërisë, paanshmërisë, përgjegjshmërisë, proporcionalitetit, efikasitetit, mbrojtjes së sekretit shtetëror dhe konfidencialitetit si dhe parime të tjera që janë përcaktuar në Ligjin Nr. 9121, datë 28.7.2003 “Për mbrojtjen e konkurrencës”, Kodin e Procedurave Administrative, Ligjin Nr. 9131 datë 08.09.2003, “Për rregullat e etikës në administratën publike”, ligjin nr. 9367, datë 7.4.2005, “Për parandalimin e konfliktit të interesave në ushtrimin e funksioneve publike”.

Neni 4

Parime të përgjithshme

- 4.1. Zyrtari, kryen detyrat e tij me përgjegjshmëri, profesionalizëm, devotshmëri dhe vendosmëri duke i kushtuar kohën dhe energjinë e duhur.
- 4.2. Zyrtari vepron në mënyrë të paanshme, shmang favorizimet e padrejta, dhuratat apo çfarëdo përfitimi tjetër që ndikojnë ose mund të ndikojnë në paanësinë e kryerjes së detyrave të tij, si dhe është transparent në marrjen e vendimeve. Zyrtari duhet të ketë kujdes që të shmangë keqkuptimet dhe pasojat negative për reputacionin e institucionit apo të nëpunësve të tij.
- 4.3. Gjatë zbatimit të detyrave të ngarkuara me ligj zyrtari duhet të krijojë një marrëdhënie besimi dhe bashkëpunimi si ndërmjet njëri-tjetrit ashtu edhe midis tij dhe palëve të treta. Për këtë qëllim, si në komunikimin me shkrim edhe në atë verbal, nëpunësi duhet të jetë i sjellshëm, i gatshëm për bashkëpunim dhe për tu përgjigjur sa më parë. Zyrtari duhet të përdorë një gjuhë të thjeshtë dhe të arsyetojë përgjigjet, duke bashkëpunuar në njohjen dhe zgjidhjen e çështjeve të ndryshme.

Neni 5

Ndalimi i diskriminimit

Ndalohet çdo dallim, përjashtim ose parapëlqim për arsye të tilla si raca, origjina kombëtare, mosha, aftësia e kufizuar, gjinia, gjendja civile, lidhjet familjare, origjina shoqërore, besimi, prirjet seksuale, bindjet politike në të gjithë veprimtarinë e Autoritetit të Konkurrencës.

Neni 6

Parimi i paanshmërisë

- 6.1. Zyrtari në ushtrim të funksioneve të tij, trajton në mënyrë të ndershme dhe të paanshme të gjitha subjektet me të cilët hyn në marrëdhënie.
- 6.2. Në ushtrimin e detyrave të tij, zyrtari:
 - a) nuk merr përsipër detyra si dhe nuk jep udhëzime apo premtime në lidhje me çështjet që hyjnë në kompetencën e organeve të Autoritetit;
 - b) nuk merr pjesë në takime jozyrtare me subjekte të interesuar për çështjet në shqyrtim, nëse kjo nuk është autorizuar nga eprori.
 - c) nuk duhet të takojë subjekte të interesuara për veprimtarinë e Autoritetit, përveç rastit kur është i pranishëm të paktën edhe një zyrtar tjetër;
- 6.3. Zyrtari i cili ndodhet apo mund të ndodhet në situatat e sipërpërmendura, duhet të informojë eprorin e drejtpërdrejtë ose Komisionin.
- 6.4. Zyrtari mund të jetë anëtar i organizatave të ndryshme politike ose jo politike. Në çdo rast pikëpamjet politike të nëpunësit apo mendimet e tij mbi politikën duhet të shprehen qartësisht në mënyrë individuale dhe jo në funksionin e tij si nëpunës i Autoritetit.

Neni 7

Konflikti i Interesave

- 7.1. Anëtari i Komisionit dhe nëpunësi në zbatimin e detyrave të tij, nuk duhet të marrë vendime ose të kryejë veprimtari që përbëjnë konflikt interesi.
- 7.2. Në kuptim të këtij Kodi Etike, konflikt interesi është gjendja në të cilën zyrtari ka interesa të drejtpërdrejtë ose të tërthortë, që ndikojnë, mund të ndikojnë ose duket sikur ndikojnë në kryerjen në mënyrë të padrejtë të detyrave dhe përgjegjësive të tij publike.

Konflikti i interesit, përfshin disa përkufizime të tjera, për lloje të ndryshme të shfaqjes së tij, si më poshtë:

- a) “Konflikt rast pas rasti interesi” është gjendja me konflikt interesi në njërën nga tri llojet e mëposhtme, që shfaqet rast pas rasti dhe lidhet me një vendimmarrje të veçantë.
 - b) “Konflikt faktik i interesit” është gjendja në të cilën interesat private të zyrtarit ndikojnë, kanë ndikuar ose mund të kenë ndikuar në kryerjen në mënyrë të padrejtë të detyrave dhe përgjegjësive të zyrtarit.
 - c) “Konflikt në dukje interesi” është gjendja në të cilën interesat e zyrtarit duken në pamje ose në formë sikur kanë ndikuar, ndikojnë ose mund të ndikojnë në kryerjen në mënyrë të padrejtë të detyrave apo përgjegjësive të zyrtarit
 - d) “Konflikt i mundshëm interesi” është gjendja në të cilën interesat e zyrtarit mund të shkaktojnë në të ardhmen shfaqjen e konfliktit faktik ose në dukje të interesit nëse zyrtari do të përfshihej në detyra apo përgjegjësi të caktuara.
- 7.3. Zyrtari kur gjendet në situatat e sipërpërmendura, i raporton me shkrim eprorit të drejtpërdrejtë, titullarit të njësisë së personelit ose Komisionit, të cilët marrin masat përkatëse, sipas procedurave e modaliteteve të përcaktuara në ligjin Nr. 9367, datë 7.4.2005 “Për parandalimin e konfliktit të interesave në ushtrimin e funksioneve publike” si dhe në Ligjin Nr. 9131 datë 08.09.2003, “Për rregullat e etikës në administratën publike”.

Neni 8

Dhuratat apo përfitimet e tjera

- 8.1. Zyrtari nuk duhet të pranojë për vete apo për të tjerët, dhurata apo mjete të tjera të cilat kanë vlerë ekonomike nga çdo subjekt, interesat e cilit preken, mund të preken apo duket sikur preken nga veprimtaria e Autoritetit, me përjashtim të dhuratave me vlerë simbolike.
- 8.2. Për mënyrën e reagimit ndaj dhuratave dhe ofertave, mbahen parasysh kriteret dhe procedurat e parashikuara në Ligjin Nr. 9131 datë 08.09.2003, “Për rregullat e etikës në administratën publike”, ose në rast se shihet e nevojshme të kryhet denoncimi në organet e ndjekjes penale.

Neni 9

Mbrojtja e personalitetit të zyrtarit

- 9.1. Çdo zyrtar mbron dhe respekton personalitetin e homologëve, vartësve dhe eprorëve të tij gjatë marrëdhënieve të punës. Ai duhet të parandalojë çdo veprim apo qëndrim që cenon dinjitetin e tjerëve.
- 9.2. Zyrtari ndalohet të kryejë çdo veprim që përbën shqetësim seksual ndaj homologëve, vartësve, eprorëve ose ndaj të tretëve. Në kuptim të këtij Kodi, shqetësim seksual konsiderohet çdo veprim i kryer nga një zyrtar i cili kërkon favore të natyrës seksuale duke përdorur ndikimin apo pozitën e tij në Autoritet.
- 9.3. Zyrtari dhe veçanërisht zyrtarët në pozicione drejtuese kujdesen që të mos ketë raste të shqetësimeve seksuale në punë ose për shkak të punës në Autoritetin e Konkurrencës. Zyrtari raporton menjëherë çdo rast shqetësimi seksual apo dyshimi për një situatë të tillë te Kryetari i Komisionit të Autoritetit të Konkurrencës.

Neni 10

Përdorimi i informacionit

- 10.1. Zyrtari nuk duhet të përdorë për qëllim përfitimi personal informacionet që siguron apo ka siguruar gjatë kryerjes së detyrës së tij. Kjo vlen edhe pas mbarimit të detyrës për sa kohë që vetë institucioni nuk bën publike të tilla informacione.
- 10.2. Zyrtari nuk duhet të nxjerrë jashtë institucionit informacione në lidhje me çështje që po shqyrtohen nga Autoriteti dhe nuk duhet të japë opinione apo gjykime për çështje të tilla, nëse nuk ka autorizimin përkatës nga titullari.
- 10.3. Zyrtari nuk duhet të japë informacion që bën të mundur identifikimin e zyrtarëve të tjerë të përfshirë në mënyrë të drejtpërdrejtë në këtë çështje.
- 10.4. Zyrtari nuk duhet të japë informacion për masat që janë marrë ose do të merren në lidhje me çështjet në shqyrtim, përpara se ato të jenë miratuar në mënyrë përfundimtare nga Autoriteti dhe t'ju jenë komunikuar zyrtarisht palëve.
- 10.5. Zyrtari kujdeset për informacionin që siguron apo ka siguruar për shkak të detyrës duke:
 - a) E ruajtur në mënyrë të sigurt;
 - b) Diskutuar për këtë informacion vetëm me zyrtarë të tjerë të Autoritetit të Konkurrencës të cilëve i duhet për të kryer detyrën e tij.

Neni 11

Marrëdhëniet me organet e medias së shkruar dhe elektronike.

- 11.1. Zyrtarët mund të bëjnë deklaratime publike në lidhje me probleme të përgjithshme të konkurrencës apo të veprimtarisë së Autoritetit të Konkurrencës. Këto deklaratime nuk duhet të paragjykojnë veprimtarinë e hetimit e të vendimmarrjes të Sekretariatit e Komisionit të Konkurrencës.

- 11.2. Për sqarime të kërkuara nga ana e organeve të medias në lidhje me veprimtarinë e Autoritetit të Konkurrencës, duhet të informohet menjëherë eprori ose Komisioni i Konkurrencës.

Neni 12

Veprimtari të tjera

Zyrtari nuk mund të zhvillojë veprimtari që janë haptazi në kundërshtim me përmbushjen e detyrave funksionale të tij.

Neni 13

Sjellja në jetën sociale

- 13.1. Zyrtari nuk duhet të përdori pozitën që ka në Autoritet për të përfituar të mira që nuk i takojnë. Në marrëdhëniet me të tretët, eviton të deklarojë ose të nënkuptojë këtë pozitë në të gjitha rastet kur kjo përmendje nuk i përgjigjet kërkesave objektive.
- 13.2. Zyrtari nuk kërkon asnjë përfitim personal që nuk i takon në bazë të ligjit, nëpërmjet përdorimit të statusit të tij si nëpunës i Autoritetit.
- 13.3. Zyrtari nuk hyn në marrëdhënie që mund të komprometojnë pavarësinë e gjykimit të tij me persona të cilët lidhen me çështjet që Autoriteti ka në shqyrtim.

Neni 14

Mbrojtja e asetëve të institucionit

Të gjithë zyrtarët duhet të kujdesen për mbrojtjen e asetëve dhe përdorimin eficient të tyre.

Neni 15

Sanksionet dhe detyrimi për informim

- 15.1. Çdo zyrtar, është i detyruar të njohë dhe të zbatojë këtë Kod Etike në ushtrimin e funksioneve të tij. Moszbatimi i këtij kodi sjell përgjegjësi disiplinore sipas legjislacionit përkatës e në veçanti Ligjit Nr. 9121, datë 28.7.2003 “Për mbrojtjen e konkurrencës”, Kodit të Punës të Republikës së Shqipërisë dhe ligjit Nr. 8549 datë 11.11.1999 “Për statusin e nëpunësit civil”.
- 15.2. Çdo zyrtar, është i detyruar të informojë Komisionin ose Sekretarin e Përgjithshëm, për çdo shkelje ose dyshim për shkelje të këtij Kodi.

Buletini Zyrtar nr.1, 2004-2007**Përmbajtja**

Vendim Nr. 2, Datë 17.03.2004 “Për Miratimin e Rregullores për Organizimin dhe Funksionimin e Autoritetit të Konkurrencës”.

Vendim Nr. 3, Datë 13.04.2004 “Për Përqëndrimin e realizuar nëpërmjet blerjes 100% të aksioneve të Bankës së Kursimeve SH.A nga Raiffeisen Zentralbank, Austri.

Vendim Nr. 4, Datë 07.05.2004 “Për Zgjedhjen e Zëvendëskryetarit të Komisionit të Konkurrencës”.

Vendim Nr.7, Datë 01.06.2004 mbi Miratimin e Rregullores “Për Zbatimin e Procedurave të Përqëndrimit të Ndërmarrjeve”.

Vendim Nr. 8, Datë 01.06.2004 mbi Miratimin e Udhëzimit “Për Formën e Njoftimit të Përqëndrimit dhe për Mundësinë për Njoftim të Thjeshtuar”.

Vendim Nr. 9, Datë 01.06.2004 mbi Miratimin e Rregullores “Për gjobat dhe lehtësimin prej tyre”.

Vendim Nr. 10, Datë 29.06.2004 mbi Miratimin e Rregullores “Për caktimin e shpenzimeve për ndjekjen e procedurave pranë Autoritetit të Konkurrencës”.

Vendim Nr. 11, Datë 12.07.2004 “Për përqëndrimin e realizuar nëpërmjet transferimit 100% të aksioneve të Bankës së Kursimeve SH.A nga Raiffesen Zentral Bank Austria AG tek Raiffesen International Bank-Holding AG”.

Vendim nr. 12, Datë 15.09.2004 “Për miratimin e rekomandimit për interpretimin e marrëveshjes për furnizimin dhe tregtimin e karburantit të avionit për aeroplanë në Aeroportin Ndërkombëtar “Nënë Tereza” ndërmjet Shoqërisë Petrolimpeks-Tiranë dhe AIR-BP- Londër.

Vendim nr.14, Datë 26.01.2005

Vendim nr.18, Datë 13.09.2005

Vendim nr.19, Date 17.09.2005

Vendim nr.21, Date 11.10.2005

Vendim nr.22, Date 17.10.2005

Vendim nr. 24, Date 09.11.2005 Per nje ndryshim ne rregulloren “Per Organizimin dhe Funksionimin e Autoritetit te Konkurrences”

Vendim nr. 26, Date 02.12.2005 Per Terheqje te dhenash nga Albania Mobile Communication sh.a

Vendim nr.27, Date 12.12.2005 Per Vendosje Gjobendaj Albanian Mobile Communication Sh.A

Vendim nr. 28, Date 23.12.2005 Per disa Vleresime dhe Rekomandime te Autoritetit te Konkurrences mbi situaten aktuale te Tregut te Sigurimeve

Vendim nr. 29, Date 23.12.2005 Per rekomandime te ndryshme ne disa ligje

Vendim nr. 33, Datë 28.02.2006 Per përqëndrimin e realizuar nëpërmjet blerjes 80% të aksioneve të Bankës Italo Shqiptare nga Kompania San Paolo IMI S.p.a

Vendim nr. 38, Date 16.05.2006 Per vendosje gjobe ndaj Çalik Seker Konsorsiyum Yatirim A.S

Vendim nr. 39, Datë 16.05.2006 Per njoftimin e përqëndrimit të realizuar nëpërmjet blerjes 60%+2 të aksioneve të Bankës Kombëtare Tregtare nga Çalik Seker Konsorsiyum Yatirim A.S.

Vendim nr. 40, Datë 25.09.2006 Per përqëndrimin e realizuar nëpërmjet blerjes 100% të aksioneve në Emporiki Bank (për pjesën prej 52.55% të 1300 aksionerëve) nga shoqëria Credit Agricole S.A

Vendim nr. 42, Datë 27.10.2006 Per rekomandimet ne lidhje me ndryshimin ne Udhezimin nr 4, date 16.06.2005 “Per disa shtesa dhe ndryshime ne Udhezimin Nr.1, date 01.01.1996 te Keshillit te Ministrave “Per Prokurimin Publik” te ndryshuar”

Vendim nr. 44, Datë 28.12.2006 Per përqëndrimin e realizuar nëpërmjet përthithjes së 80% të aksioneve të San Paolo IMI S.p.a në BIA tek Banka Intesa S.p.a

Vendim nr. 45, Datë 19.01.2007 Per hapjen e procedures se Hetimit te thelluar ne tregun e sigurimit per produktin TPL (TPL e brendshme, Police Kufitare, Karton Jeshil)

Vendim nr. 46, Datë 19.01.2007 Per pranimin e dy Rregulloreve te perështatura te BE

Vendim nr. 48, Datë 21.03.2007 Mbi njoftimin e përqëndrimit të realizuar nëpërmjet shitblerjes 100% të aksioneve në Gallaher Group Plc tek Japan Tabacco Inc

Vendim nr. 49, Datë 21.03.2007 Për rekomandime të ndryshimeve në disa akte normative në fushën e sigurimeve

Vendim nr. 50, Datë 21.03.2007 Për vendosje gjobe ndaj shoqërive që veprojnë në tregun e sigurimit të detyrueshëm, për produktin Policë Kufitare

Vendim nr. 51, Datë 09.05.2007 Për përqëndrimin e realizuar nëpërmjet shitblerjes së 80% të aksioneve të Bankës Amerikane të Shqipërisë tek Intesa SanPaolo S.p.a

Vendim nr. 52, Datë 21.06.2007 Për njoftimin e përqëndrimit të realizuar nëpërmjet shitblerjes 75.006 % të aksioneve në Bankën Popullore nga shoqëria Societe General S.A”

Vendim nr. 54, Datë 13.07.2007 Mbi njoftimin e përqëndrimit të realizuar nëpërmjet shitblerjes 76% të aksioneve në Albtelekom Sh.a tek Çetel S.A”

Vendim nr. 55, Datë 11.09.2007 Mbi autorizimin e përqëndrimit të realizuar nëpërmjet shitblerjes së 75%+1 të aksioneve të Sigma sha nga shoqëria TBIH Financial Servis Group N.V(TBIH)

Vendim nr. 56, Datë 24.09.2007 Për “Ndalimin e Marrëveshjes në Tregun e Prodhimit të Betonit në Qarkun e Tiranës”



Republika e Shqipërisë
Autoriteti i Konkurrencës

BULETINI ZYRTAR, NR.2, 2007